



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 36

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E premte, 16 mars 2018

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 8/2018 datë 26.2.2018	Për ratifikimin e traktatit që themelon Komunitetin e Transportit.....	2271
Ligj nr. 9/2018 datë 5.3.2018	Për një ndryshim në ligjin nr. 9875, datë 14.2.2008, “Për metrologjinë”, të ndryshuar.....	2314
Ligj nr. 10/2018 datë 5.3.2018	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës, Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Qeverisë së Malit të Zi, Qeverisë së Republikës së Serbisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovenisë për ngritjen e Task-Forcës Mjekësore të Ballkanit.....	2314
Ligj nr. 11/2018 datë 5.3.2018	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik 2017, për projektin “Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe rajonal, nxitja e punësimit dhe arsimit profesional (shtim i dytë fondesh)”.....	2317



LIGJ
Nr. 8/2018

**PËR RATIFIKIMIN E TRAKTATIT QË
THEMELON KOMUNITETIN
E TRANSPORTIT**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet traktati që themelon Komunitetin e Transportit, sipas tekstit bashkëlidhur.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 26.2.2018

Shpallur me dekretin nr. 10738, datë 12.3.2018, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

2 qershor 2017

**TRAKTATI QË THEMELON
KOMUNITETIN E TRANSPORTIT**

Palët që janë:

Bashkimi Evropian, që në vijim në dokument do të referohen si “Bashkimi” ose “Bashkimi Evropian”,

dhe

Palët e Evropës Juglindore, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Republika ish-Jugosllave e Maqedonisë, Kosova* (këtu e më poshtë referuar si Kosova), Mali i Zi, Serbia,

dhe të gjitha palët përmendur më sipër do të referohen në vijim në këtë dokument së bashku si “Palët kontraktuese”,

duke u bazuar në punën e kryer në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit mbi zhvillimin e

Rrjetit Kryesor Rajonal të Transportit të Evropës Juglindore, të nënshkruar në Luksemburg, më 11 qershor 2004; dhe

duke vërejtur se ky Memorandum Mirëkuptimi nuk do të jetë më i rëndësishëm;

duke njohur karakterin e integruar të transportit ndërkombëtar dhe duke dëshiruar të krijojnë një Komunitet transporti ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Palëve të Evropës Juglindore bazuar në integrimin progresiv të tregut të transportit të Palëve kontraktuese, në mbështetje të bazës ligjore përkatëse të kuadrit ligjor të BE-së - *acquis*;

duke pasur parasysh se rregullat lidhur me Komunitetin e Transportit duhet të zbatohen mbi një bazë shumëpalëshe brenda Komunitetit të Transportit dhe si rrjedhojë duhen përcaktuar rregulla specifike në këtë drejtim;

duke vërejtur Marrëveshjen e Përkohshme dhe Memorandumin përkatës mbi Masat Praktike që Greqia dhe Republika ish-Jugosllave e Maqedonisë kanë nënshkruar më 1995-ës;

duke rënë dakord se është e përshtatshme që të bazohen rregullat e Komunitetit të Transportit mbi legjislacionin përkatës në fuqi brenda Bashkimit Evropian, siç përcaktohet në aneksin I të këtij Traktati, nën Traktatin e Bashkimit Evropian dhe Traktatin mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian, dhe duke marrë në konsideratë modifikimet në traktatet e mëparshme që përmbahen në sa më sipër, përfshirë edhe zëvendësimin e “Komunitetit Evropian” nga “Bashkimi Evropian”;

duke pasur parasysh se integrimi i tregjeve të transportit nuk mund të arrihet me një hap, por nëpërmjet një tranzicioni që lehtësohet dhe koordinohet me marrëveshje specifike me kohëzgjatje të kufizuar;

duke theksuar se operatorët e transportit duhet të trajtohen në mënyrë jodiskriminuese lidhur me aksesin në infrastrukturën e transportit;

duke pasur parasysh dëshirën e secilës prej Palëve të Evropës Juglindore që t’i bëjnë ligjet e tyre mbi transportin dhe çështjet që lidhen me to, të përputhshme me ato të Bashkimit Evropian, përfshirë edhe në lidhje me zhvillimet në të ardhmen të kuadrit ligjor të *acquis* brenda Bashkimit;

duke njohur rëndësinë e asistencës teknike në këtë drejtim;

* Ky përcaktim nuk cenon pozicionet mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën UNSCR 1244/1999 dhe Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mbi deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.



duke pasur parasysh nevojën për të mbrojtur mjedisin dhe për të luftuar kundër ndryshimeve klimaterike, dhe se zhvillimi i transportit duhet të jetë i qëndrueshëm;

duke pasur parasysh nevojën për të marrë në konsideratë dimensionin social të Komunitetit të Transportit dhe për të ndërtuar strukturat e dialogut social te Palët e Evropës Juglindore;

duke pasur parasysh se perspektiva evropiane e Palëve të Evropës Juglindore siç konfirmohet së fundi nga disa samite evropiane;

duke vërejtur se Republika ish-Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi, Republika e Serbisë dhe Republika e Shqipërisë janë vende kandidatë për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe se Bosnja dhe Hercegovina gjithashtu kanë aplikuar për anëtarësim;

duke vërejtur se procedurat e brendshme të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian mund të zbatohen në momentin e marrjes së dokumenteve të lëshuara nga autoritetet kosovare sipas kësaj Marrëveshjeje;

duke vërejtur vendosmërinë e vendeve kandidatë dhe vendeve potenciale që të afrohen më tej drejt Bashkimit Evropian dhe të zbatojnë kuadrin ligjor të BE-së (*acquis*), veçanërisht në fushën e transportit,

kanë vendosur të krijojnë një komunitet transporti:

Objektivat dhe parimet

Neni 1

1. Qëllimi i këtij Traktati është krijimi i një Komuniteti Transporti në fushën e transportit rrugor, hekurudhor, ujqor të brendshëm dhe detar, si dhe zhvillimi i rrjetit të transportit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Palëve të Evropës Juglindore, që në vijim në këtë dokument do të referohet si Komuniteti i Transportit. Komuniteti i Transportit do të bazohet mbi integrimin progresiv të tregjeve të transportit të Palëve të Evropës Juglindore në tregun e transportit të Bashkimit Evropian, mbi bazën e kuadrin ligjor përkatës të *acquis*, përfshirë edhe në sferat e standardeve teknike, ndër funksionimin, sigurinë, politikën sociale, menaxhimin e trafikut, prokurimin publik dhe mjedisin, për të gjitha format e transportit me përjashtim të transportit ajror. Për këtë qëllim, ky Traktat përcakton rregullat e zbatueshme ndërmjet Palëve Kontraktuese nën kushtet e përcaktuara në

vijim. Këto rregulla përfshijnë dispozitat e parashtruara nga aktet e specifikuar në aneksin I.

2. Dispozitat e këtij Traktati do të zbatohen në shkallën që lidhen me transportin rrugor, hekurudhor, ujqor të brendshëm, detar dhe rrjetet e transportit, përfshirë edhe infrastrukturën e aeroporteve ose çështje që lidhen me to, të referuara në aneksin I.

3. Ky Traktat përbëhet nga nene që përcaktojnë funksionimin e përgjithshëm të Komunitetit të Transportit, që në vijim në këtë dokument do të referohet si “Traktati kryesor”, nga anekse, prej të cilave aneksi I përmban akte të Bashkimit Evropian të zbatueshme ndërmjet Palëve kontraktuese në kuadrin e Traktatit kryesor dhe nga protokolle, prej të cilave të paktën një nga secila prej Palëve të Evropës Juglindore harton dispozitat kalimtare të zbatueshme për to.

Neni 2

1. Për qëllimet e këtij Traktati:

a) Termi “Traktat” nënkupton Traktatin kryesor, anekset e tij, aktet e referuara në aneksin I, si edhe në protokollin e tij.

b) Termi “Palë të Evropës Juglindore” nënkupton Republikën e Shqipërisë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Republikën ish-Jugosllave të Maqedonisë, Kosovën, Malin e Zi dhe Republikën e Serbisë.

c) Asnjë prej termave, teksteve dhe përkufizimeve të përdorur në këtë Marrëveshje, përfshirë anekset dhe protokollin në to, nuk përbën njohjen e Kosovës nga BE-ja si një shtet i pavarur dhe as nuk përbën njohje të Kosovës prej ndonjë shteti individual në këtë cilësi, në rastet kur këto shtete nuk e kanë ndërmarrë këtë hap.

d) Termi “Konventë” nënkupton çdo marrëveshje apo konventë ndërkombëtare mbi transportin ndërkombëtar të hapur për nënshkrim, përveç këtij Traktati.

e) Termi “Shtet anëtar i BE-së” nënkupton një shtet anëtar të Bashkimit Evropian.

f) Termi “*acquis*” nënkupton korpusin e legjislacionit të miratuar nga Bashkimi Evropian, me qëllim përmbushjen e objektivave të tij.

2. Përdorimi i termave “vend”, “kombëtar”, “qytetarë të një vendi”, “territor” ose “flamur” nuk cenon statusin e secilës Palë kontraktuese sipas së drejtës ndërkombëtare.



Neni 3

1. Dispozitat e zbatueshme të akteve ligjore të referuara apo që përmbahen në aneksin I, të përshtatura në përputhje me aneksin II ose vendimet e Komitetit Rajonal Drejtues, do të jenë detyruese për Palët Kontraktuese.

2. Dispozita të tilla do të jenë ose do të bëhen pjesë e rendit të tyre të brendshëm ligjor për Palët e Evropës Juglindore si vijon:

a) Një akt që i korrespondon një rregulloreje të Bashkimit Evropian do të bëhet pjesë e rendit të brendshëm ligjor të Palës përkatëse të Evropës Juglindore brenda një periudhe kohe që do të përcaktohet për Palën e Evropës Juglindore nga Komiteti Rajonal Drejtues.

b) Një akt që i korrespondon një direktive të Bashkimit Evropian do t'u lihet si zgjedhje autoriteteve të Palës përkatëse të Evropës Juglindore në lidhje me formën dhe metodën e zbatimit.

c) Një akt që i korrespondon një vendimi të Bashkimit Evropian do të bëhet pjesë e rendit të brendshëm ligjor të Palës përkatëse të Evropës Juglindore brenda një periudhe që do të përcaktohet për Palën e Evropës Juglindore nga Komiteti Rajonal Drejtues.

3. Në rastet kur dispozitat e zbatueshme të akteve ligjore të referuara në paragrafin 1 krijojnë detyrime nga ana e shteteve anëtare të BE-së, këto detyrime do të zbatohen për shtetet anëtare të BE-së, në vijim të një vendimi miratuar nën rregullat që zbatohen brenda Bashkimit Evropian, bazuar në një vlerësim nga Komisioni në lidhje me zbatimin e plotë nga një Palë e Evropës Juglindore të akteve ligjore të BE-së të referuara në aneksin I.

Neni 4

Palët kontraktuese do të marrin të gjitha masat e nevojshme, të përgjithshme apo të veçanta, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga ky Traktat dhe do të heqin dorë nga çdo masë që mund të vërë në rrezik arritjen e objektivave të këtij Traktati.

Çështjet sociale

Neni 5

Palët e Evropës Juglindore do të zbatojnë pjesën përkatëse sociale të *acquis* lidhur me transportin, siç përcaktohet në aneksin I.

Komiteti i Transportit do të forcojë dhe do të inkurajojë dialogun social dhe dimensionin social, duke iu referuar kuadrit të *acquis* në çështjet sociale, të drejtave themelore të punonjësve dhe përfshirjes së Komitetit Evropian Ekonomik e Social dhe partnerëve socialë evropianë, që veprojnë në sektorin e transportit, në nivelin e duhur.

Mjedisi

Neni 6

Palët e Evropës Juglindore do të zbatojnë pjesën përkatëse mjedisore të *acquis* lidhur me transportin, në veçanti Vlerësimin Mjedisor Strategjik, Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor, direktivat që lidhen me natyrën, ujin, cilësinë e ajrit, siç parashtrohet në aneksin I.6.

Prokurimi publik

Neni 7

Palët e Evropës Juglindore do të zbatojnë pjesën përkatëse të *acquis* për prokurimin publik lidhur me transportin, siç parashtrohet në aneksin I.7.

Infrastruktura

Neni 8

1. Hartat e Rrjetit Indikativ të Transportit Trans-Evropian (TENT-I) zgjatim në Ballkanin Perëndimor të Rrjeteve Kryesore dhe Gjithëpërfshirëse janë bashkëlidhur në këtë Traktat si aneksi I.1. Komiteti Rajonal Drejtues do t'i raportojë çdo vit Këshillit Ministerial mbi realizimin e Rrjetit që përshkruhet në këtë Traktat. Komitetet teknike do të asistojnë Komitetin Rajonal Drejtues për përgatitjen e këtij raporti.

2. Komiteti i Transportit do të mbështesë zhvillimin e Zgjatimit Indikativ TEN-T të Rrjeteve Kryesore dhe Gjithëpërfshirëse në Ballkanin Perëndimor, në përputhje me Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) 2016/758*, të datës 4 shkurt 2016, siç parashtrohet në aneksin I.1. Ai do të marrë në konsideratë marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe lidhur me to, të lidhura nga Palët kontraktuese, duke përfshirë edhe zhvillimin e lidhjeve kyçe dhe ndërlidhjeve që

* Rregullorja e deleguar e Komisionit (BE) 2016/758, e datës 4 shkurt 2016, me të cilën ndryshohet Rregullorja (BE) nr. 1315/2013, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit në lidhje me përshtatjen e aneksit III, sipas saj (OJ BE L 126, 14.5.2016, faqja 3).



nevojiten për të eliminuar pengesat dhe për të inkurajuar ndërlidhjen e rrjeteve kombëtare edhe me rrjetet e Transportit Trans-Evropian të BE-së.

Neni 9

1. Komuniteti i Transportit do të përgatisë çdo dy vjet një plan pune funksional 5-vjeçar për zhvillimin e Zgjatimit Indikativ TEN-T të Rrjeteve Kryesore dhe Gjithëpërfshirës në Ballkanin Perëndimor, si edhe identifikimin e projekteve prioritare me interes rajonal në përputhje me praktikën më të mirë të Bashkimit, të cilat do të kontribuojnë për zhvillimin e balancuar të qëndrueshëm në aspektin ekonomik, të integritimit hapësinor, të ndikimit social dhe mjedisor, si dhe kohezionit social.

2. Ndër të tjera, ky plan pune funksional 5-vjeçar:

a) Do të jetë në përputhje me legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian që parashtrohet në aneksin I, në veçanti kur parashikohet financim nga Bashkimi Evropian;

b) Do të demonstrojë vlerën më të mirë kundrejt parave dhe ndikim më të gjerë social-ekonomik, në përputhje me rregullat e financimit të donatorit dhe me praktikën dhe standardet më të mira ndërkombëtare;

c) Do t'u kushtojë vëmendje të veçantë ndryshimeve klimaterike globale dhe qëndrueshmërisë mjedisore në fazën e përcaktimit dhe analizës së projekteve;

d) Do të përfshijë mundësi financimi nga donatorë dhe Institucione Financuese Ndërkombëtare (IFN), në veçanti nëpërmjet Kuadrit të Investimeve të Ballkanit Perëndimor.

3. Komuniteti i Transportit do të inkurajojë studimet dhe analizat e nevojshme, në veçanti në lidhje me përshtatshmërinë dhe mundësinë ekonomike, specifikimet teknike, ndikimin mjedisor, pasojat sociale dhe mekanizmat financiarë.

4. Një sistem informacioni do të ngrihet nga Sekretariati i Përhershëm, që do të përdoret nga vendimmarrësit në monitorimin dhe rishikimin e kushteve dhe performancës së Zgjatimit Indikativ TEN-T të Rrjeteve Kryesore dhe Gjithëpërfshirëse në Ballkanin Perëndimor.

Neni 10

Palët e Evropës Juglindore do të zhvillojnë sisteme efikase të menaxhimit të trafikut, duke përfshirë edhe sisteme intermodale dhe sisteme inteligjente të transportit.

Transporti hekurudhor

Neni 11

1. Brenda kuadrit dhe kushteve të këtij Traktati dhe të parashtruara nga aktet përkatëse të specifikuar në aneksin I, sipërmarrjet hekurudhore të licencuara në një shtet anëtar të BE-së ose nga një Palë e Evropës Juglindore, do të kenë të drejtën e aksesit në infrastrukturë në të gjitha shtetet anëtare të BE-së dhe te Palët e Evropës Juglindore, me synim kryerjen dhe funksionimin e shërbimeve ndërkombëtare të transportit hekurudhor të pasagjerëve dhe mallrave.

2. Brenda kuadrit dhe kushteve të këtij Traktati dhe të parashtruara nga aktet përkatëse të specifikuar në aneksin I, nuk do të ketë kufizime mbi vlefshmërinë e licencave të sipërmarrjeve hekurudhore, certifikatave të tyre të sigurisë, dokumenteve të certifikimit të makinistëve të trenave dhe autorizimet e automjeteve hekurudhore të lëshuara nga BE ose nga autoriteti kompetent i një shteti anëtar ose nga një Palë e Evropës Juglindore.

Transporti rrugor

Neni 12

Palët e Evropës Juglindore inkurajojnë funksionim efikas, të sigurt dhe me siguri operimi për transportin rrugor. Operacionet e përbashkëta ndërmjet Palëve kontraktuese synojnë të arrijnë harmonizim drejt standardeve të operimit dhe politikave mbi transportin rrugor në Bashkimin Evropian, veçanërisht duke u zbatuar kuadri ligjor *acquis* i transportit rrugor, siç referohet në aneksin I.

Transporti ujqor i brendshëm

Neni 13

Palët kontraktuese inkurajojnë funksionim efikas, të sigurt dhe me siguri operimi për transportin ujqor të brendshëm. Operacionet e përbashkëta ndërmjet Palëve kontraktuese synojnë të arrijnë harmonizim drejt standardeve të operimit dhe politikave mbi transportin ujqor të brendshëm në Bashkimin Evropian, veçanërisht



nëpërmjet zbatimit nga Palët e Evropës Juglindore të akteve që referohen në aneksin I.

Transporti detar

Neni 14

Palët kontraktuese inkurajojnë funksionim efikas, të sigurt dhe me siguri operimi për transportin detar. Operacionet e përbashkëta ndërmjet Palëve kontraktuese synojnë të arrijnë harmonizim drejt standardeve të operimit dhe politikave mbi transportin detar në Bashkimin Evropian, veçanërisht nëpërmjet zbatimit nga Palët e Evropës Juglindore të akteve, siç referohet në aneksin I.

Lehtësimi i formaliteteve administrative

Neni 15

1. Palët kontraktuese do të lehtësojnë procedurat administrative (formalitetet) për kalimin nga një territor doganor në tjetrin, në përputhje me dispozitat e bashkëpunimit doganor të marrëveshjeve të zbatueshme ndërmjet Bashkimit Evropian nga njëra anë dhe secilës prej Palëve të Evropës Juglindore nga ana tjetër.

2. Me të njëjtët objektiva, Palët e Evropës Juglindore do të lehtësojnë procedurat administrative për kalimin nga një territor doganor në tjetrin, në përputhje me dispozitat e bashkëpunimit doganor të Marrëveshjeve të zbatueshme ndërmjet tyre.

Mosdiskriminimi

Neni 16

Brenda kuadrit të këtij Traktati dhe pa kundërshti ndaj ndonjë dispozite të veçantë që përmbahet këtu, do të ndalohet çdo diskriminim mbi baza të kombësisë.

Konkurrenca

Neni 17

1. Brenda kuadrit të këtij Traktati do të zbatohen dispozitat e aneksit III. Në rastet kur përfshihen rregulla mbi konkurrencën dhe ndihmën shtetërore në marrëveshje të tjera ndërmjet dy apo më shumë Palëve kontraktuese, të tilla si marrëveshjet e asociimit, këto rregulla do të zbatohen ndërmjet atyre Palëve.

2. Nenet 18, 19 dhe 20 nuk zbatohen për sa u përket dispozitave në aneksin III në lidhje me

konkurrencën. Ato do të jenë të zbatueshme në lidhje me ndihmën shtetërore.

Ushtrimi i ligjit

Neni 18

1. Pa kundërshti ndaj paragrafit 2, secila Palë kontraktuese siguron që të drejtat që rrjedhin nga ky Traktat dhe në veçanti nga aktet e specifikuar në aneksin I, mund të apelojnë para gjykatave kombëtare.

2. Të gjitha çështjet në lidhje me ligjshmërinë e legjislacionit të miratuar nga Bashkimi Evropian, të specifikuar në aneksin I, do të jenë kompetencë ekskluzive e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian, e cila në vijim në këtë dokument referohet si “Gjykata e Drejtësisë”.

Interpretimi

Neni 19

1. Në masën që dispozitat e këtij Traktati dhe dispozitat e akteve të specifikuar në aneksin I janë identike në përmbajtje në lidhje me rregullat korresponduese të Traktatit mbi Bashkimin Evropian dhe Traktatin mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian, dhe akteve të miratuara në zbatim të këtyre Traktateve, këto dispozita, në zbatimin dhe aplikimin e tyre, do të interpretohen në përputhje me vendimet përkatëse të Gjykatës së Drejtësisë dhe vendimet e Komisionit Evropian të dhëna para datës së nënshkrimit të këtij Traktati. Gjykimet dhe vendimet e dhëna pas datës së nënshkrimit të këtij Traktati do t’u komunikohen Palëve të tjera kontraktuese. Me kërkesë të një prej Palëve kontraktuese, implikimet e këtyre gjykimeve dhe vendimeve të mëvonshme do të përcaktohen nga Komiteti Rajonal Drejtues i asistuar nga Komitetet teknike, me qëllim që të sigurohet funksionimi i duhur i këtij Traktati. Interpretimet ekzistuese do t’u komunikohen Palëve të Evropës Juglindore para datës së nënshkrimit të këtij Traktati. Vendimet e marra nga Komiteti Rajonal Drejtues sipas kësaj procedure do të jenë në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë.

2. Kur lind ndonjë çështje për interpretimin e këtij Traktati, të dispozitave të akteve dhe dispozitat e akteve të specifikuar në aneksin I ose akteve të nxjerra në zbatim të tyre, të cilat kanë përmbajtje me rregullat korresponduese të



Traktatit mbi Bashkimin Evropian dhe Traktatit mbi Funkcionimin e Bashkimit Evropian ose të akteve të nxjerra në zbatim të këtyre Traktateve, në një çështje në shqyrtim para një gjykate apo tribunali të një Pale të Evropës Juglindore, gjykata apo tribunali, nëse e çmon të nevojshme të japë një vendim dhe që të jetë në përputhje me aneksin IV, do t'i kërkojë Gjykatës së Drejtësisë të vendosë mbi çështjen. Një palë e Evropës Juglindore, me vendim dhe në përputhje me aneksin IV, mund të përcaktojë shkallën në të cilën dhe në përputhje me cilat modalitete gjykatat dhe tribunalet në vendin e vet do të zbatojnë këtë dispozitë. Një vendim i tillë do t'i njoftohet depozitarit dhe Gjykatës së Drejtësisë. Depozitari do të informojë Palët e tjera kontraktuese. Vendimi paraprak i Gjykatës së Drejtësisë do të jetë detyrues për gjykatat e Palëve të Evropës Juglindore që trajtojnë rastin në të cilin ka lindur çështja.

Legjislacioni i ri

Neni 20

1. Ky Traktat do të jetë pa kundërshti ndaj së drejtës së çdo Pale të Evropës Juglindore që i nënshtrohet parimit të mosdiskriminimit dhe dispozitave të këtij neni, për të miratuar legjislacion të ri apo ndryshuar legjislacionin e vet ekzistues në fushën e transportit apo një sferë të lidhur me të në aneksin I. Palët e Evropës Juglindore nuk do të nxjerrin ndonjë legjislacion të tillë nëse nuk është në përputhje me këtë Traktat.

2. Pasi një Palë e Evropës Juglindore të ketë nxjerrë legjislacion të ri apo të ketë ndryshuar legjislacionin e vet, do të informojë Palët e tjera kontraktuese nëpërmjet Komitetit Rajonal Drejtues, jo më vonë se një muaj nga nxjerrja e aktit. Me kërkesë të çdonjërit prej Palëve kontraktuese, Komiteti Teknik përkatës, brenda dy muajsh nga ky moment, do të kryejë shkëmbim pikëpamjesh mbi implikimet e një legjislacioni të ri apo amendimi të tillë, në kuadër të funksionimit të duhur të këtij Traktati.

3. Komiteti Rajonal Drejtues, në lidhje me aktet e reja detyruese të Bashkimit Evropian:

a) do të nxjerrë një vendim që rishikon aneksin I, në mënyrë që ta integrojë aty aktin e ri në fjalë, nëse është e nevojshme mbi bazë reciprociteti; ose

b) do të nxjerrë një vendim të tillë që të ketë efektin që akti i ri në fjalë të konsiderohet në përputhje me këtë Traktat; ose

c) do të vendosë në lidhje me ndonjë masë tjetër për të ruajtur funksionimin e duhur të këtij Traktati.

4. Në lidhje me aktet e reja ligjërish detyruese të Bashkimit, të cilat janë nxjerrë në kohën ndërmjet nënshkrimit të këtij Traktati dhe hyrjes së tij në fuqi, dhe të kohës kur Palët e tjera kontraktuese janë informuar, data e referimit do të konsiderohet si data në të cilën është marrë informacioni. Data kur Komiteti Rajonal Drejtues merr një vendim nuk mund të jetë më herët se gjashtëdhjetë ditë pas hyrjes në fuqi të këtij Traktati.

Këshilli Ministerial

Neni 21

Krijohet Këshilli Ministerial. Ai do të sigurojë që të arrihen objektivat e parashtruar në këtë Traktat. Ai:

a) do të japë udhëzime të përgjithshme politikash;

b) do të shqyrtojë progresin mbi zbatimin e këtij Traktati, duke përfshirë edhe propozimet për vijimësinë e përcaktuar nga Forumi Social;

c) do të japë opinione për caktimin e Drejtorit të Sekretariatit të Përhershëm;

d) do të vendosë selinë e Sekretariatit të Përhershëm me konsensus.

Neni 22

Këshilli Ministerial do të përbëhet nga një përfaqësues të secilës Palë kontraktuese. Pjesëmarrja si vëzhgues do të jetë e hapur për të gjitha shtetet anëtare të BE-së.

Neni 23

Këshilli Ministerial do të takohet mbi bazë vjetore.

Komiteti Rajonal Drejtues

Neni 24

1. Me këtë akt ngrihet një Komitet Rajonal Drejtues, që do të jetë përgjegjës për administrimin e këtij Traktati dhe do të sigurojë zbatimin e duhur të tij pa kundërshti ndaj nenit 19. Për këtë qëllim, ai do të bëjë rekomandime dhe do të marrë vendime në rastet që përcakton ky Traktat. Vendimet e Komitetit Rajonal Drejtues do të hyjnë në fuqi nga Palët kontraktuese, në përputhje me rregullat e tyre.



2. Komiteti Rajonal Drejtues do të përbëhet nga një përfaqësues dhe një përfaqësues alternativ i Palëve kontraktuese. Pjesëmarrja si vëzhgues do të jetë e hapur për të gjitha shtetet anëtare të BE-së.

3. Komiteti Rajonal Drejtues do të veprojë me unanimitet.

4. Me qëllim që të zbatohet ky Traktat, Palët kontraktuese do të shkëmbejnë informacion, ndër të tjera, mbi legjislacionin e ri apo vendimet që janë të rëndësishme për këtë Traktat dhe, me kërkesë të çdonjërës prej Palëve kontraktuese, do të kryejnë konsultime brenda Komitetit Drejtues Rajonal, përfshirë edhe për çështjet sociale.

5. Komiteti Rajonal Drejtues do të nxjerrë rregullat e veta të procedurës.

6. Një Palë e Evropës Juglindore do të kryesojë Komitetin Rajonal Drejtues me rotacion, në përputhje me dispozitat që do të parashtrihen në rregullat përkatëse të procedurës.

7. Kryetari i Komitetit Rajonal Drejtues do të thërrasë mbledhjet e tij të paktën dy herë në vit, me qëllim që të shqyrtohet funksionimi i përgjithshëm i këtij Traktati dhe, kurdoherë që ta kërkojnë kushtet, me kërkesën e një Pale kontraktuese. Komiteti Rajonal Drejtues do të mbajë nën shqyrtim të vazhdueshëm zhvillimin e ligjit mbi bazë rasti të Gjykatës së Drejtësisë. Për këtë qëllim, Bashkimi Evropian do t'i transmetojë secilës prej Palëve të Evropës Juglindore të gjitha vendimet e Gjykatës së Drejtësisë që janë të rëndësishme për funksionimin e këtij Traktati. Komiteti Rajonal Drejtues do të veprojë brenda tre muajsh, në mënyrë që të ruhet interpretimi homogjen i këtij Traktati.

8. Komiteti Rajonal Drejtues do të përgatisë punën për Këshillin Ministerial.

Neni 25

1. Një vendim i Komitetit Rajonal Drejtues do të jetë detyrues ndaj Palëve kontraktuese.

Kurdoherë që një vendim i marrë nga Komiteti Rajonal Drejtues përmban një kërkesë për veprim që duhet ndërmarrë nga një Palë kontraktuese, Pala në fjalë do të marrë masat e nevojshme dhe do të informojë më pas Komitetin Rajonal Drejtues.

2. Vendimet e Komitetit Rajonal Drejtues do të botohen në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian dhe të Palëve të Evropës Juglindore. Çdo vendim do të përcaktojë datën e tij të zbatimit nga një Palë kontraktuese dhe çdo informacion tjetër që

mund të jetë i rëndësishëm për operatorët ekonomikë.

Komitetet teknike

Neni 26

1. Komiteti Rajonal Drejtues do të vendosë për ngritjen e Komiteteve teknike, në formën e grupeve të posaçme. Çdo Komitet teknik mund të bëjë propozime në sferën e vet të përgjegjësisë të Komitetit Rajonal Drejtues, i cili merr vendim. Komitetet teknike do të përbëhen nga përfaqësuesit e Palëve kontraktuese. Pjesëmarrja si vëzhgues do të jetë e hapur për të gjitha shtetet anëtare të BE-së.

Mbi bazë *ad hoc* do të ftohen si vëzhgues organizata të shoqërisë civile përkatëse dhe, në veçanti, ato mjedisore.

2. Komitetet teknike do të nxjerrin rregullat e tyre të procedurës.

3. Një Palë e Evropës Juglindore do të kryesojë me rotacion komitetet teknike në përputhje me dispozitat që do të parashtrihen në rregullat e procedurës.

Forumi social

Neni 27

1. Palët kontraktuese do t'i kushtojnë vëmendjen e duhur dimensionit social dhe do të njohin nevojën që të përfshijnë partnerët socialë në të gjitha nivelet e duhura, duke promovuar dialogun social në lidhje me monitorimin dhe zbatimin e Traktatit dhe efektet e tij.

2. Ato do të marrin në konsideratë rëndësinë e fokusimit të vëmendjes së tyre në sferat kyçe më poshtë:

a) të drejtat themelore të punonjësve sipas Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, Kartës Sociale Evropiane, Kartës së Komunitetit të të Drejtave Sociale Themelore të Punonjësve dhe Kartës së BE-së për të Drejtat Themelore;

b) ligjet e punës - në lidhje me nxitjen e përmirësimit të kushteve të punës dhe standardeve të jetesës;

c) shëndeti dhe siguria në punë - në lidhje me përmirësimet në mjedisin e punës, në lidhje me shëndetin dhe sigurinë e punonjësve të sektorit të transportit;

d) mundësitë e barabarta - me fokus prezantimin, kur është e nevojshme, të parimit se



burrat dhe gratë duhet të marrin pagë të njëjtë për punë të njëjtë.

3. Për t'iu drejtuar këtyre çështjeve sociale, Palët kontraktuese do të bien dakord që të ngrenë një Forum social. Secila Palë kontraktuese, në përputhje me procedurat e veta të brendshme, do të caktojë përfaqësuesit e vet që mund të marrin pjesë në mbledhjet përkatëse të Forumit social. Përfaqësimi do të mbulojë qeveritë, si dhe organizatat e punonjësve dhe punëdhënësve dhe çdo organ tjetër përkatës që konsiderohen të përshtatshëm në përputhje me temat e diskutuara. Komitetet evropiane të dialogut social që lidhen me sektorin e transportit do të jenë të pranishme dhe do të marrin pjesë në mbledhje, si dhe përfaqësuesit e Komitetit Evropian Ekonomik dhe Social. Forumi social do të përcaktojë rregullat e veta të procedurës.

Sekretariati i Përhershëm

Neni 28

Sekretariati i Përhershëm:

a) Do të japë mbështetje administrative për Këshillin Ministerial, Komitetin Rajonal Drejtues, Komitetet teknike dhe Forumin social;

b) Do të veprojë si një observator transporti për të monitoruar performancën e Zgjatimit Indikativ TEN-T të Rrjeteve Kryesore dhe Gjithëpërfshirëse në Ballkanin Perëndimor;

c) Do të mbështesë zbatimin e Agjendës së Ndërlidhjes të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor (BP6), që synon të përmirësojë lidhjet brenda Ballkanit Perëndimor, si dhe ndërmjet rajonit dhe BE-së.

Neni 29

Sekretariati i Përhershëm do të përbëhet nga drejtori dhe personel të tillë që mund të kërkojë Komuniteti i Transportit. Sekretariati i Përhershëm mund të përbëhet nga një ose më shumë zëvendës drejtorë. Gjuha e punës do të jetë anglishtja.

Neni 30

Drejtori i Sekretariatit të Përhershëm do të caktohet nga Komiteti Rajonal Drejtues pas konsultimeve me Këshillin Ministerial. Kohëzgjatja e mandatit të tij/saj nuk do të kalojë tre vjet. Mandati mund të rinovohet. Komiteti Rajonal Drejtues do të përcaktojë rregullat e Sekretariatit të

Përhershëm, veçanërisht për rekrutimin, kushtet e punës dhe ekuilibrin gjeografik të personelit të Sekretariatit. Komiteti Rajonal Drejtues mund të caktojë edhe një ose më shumë zëvendës drejtorë. Drejtori do të përzgjedhë dhe caktojë stafin pas konsultimeve me Komitetin Rajonal Drejtues.

Neni 31

Në kryerjen e detyrave të tyre, drejtori dhe personeli i Sekretariatit të Përhershëm do të veprojnë në mënyrë të paanshme dhe nuk do të kërkojnë dhe, as nuk do të marrin udhëzime nga ndonjëra prej Palëve kontraktuese. Ata do të promovojnë interesat e Komunitetit të Transportit.

Neni 32

Drejtori dhe Sekretariati i Përhershëm ose një person alternativ i caktuar do të asistojnë mbledhjet e Këshillit Ministerial, Komitetit Rajonal Drejtues, Komiteteve teknike dhe Forumit social.

Neni 33

Selia e Sekretariatit të Përhershëm do të vendoset në përputhje me nenin 21(d).

Buxheti

Neni 34

Secila Palë kontraktuese do të kontribuojë për buxhetin e Komuniteti të Transportit, siç parashtrohet në aneksin V. Niveli i kontributeve mund të rishikohet çdo tre vjet, me kërkesë të çdonjërës prej Palëve kontraktuese, nga një vendim i Komitetit Rajonal Drejtues.

Neni 35

Komiteti Rajonal Drejtues do të miratojë buxhetin e Komunitetit të Transportit çdo vit. Buxheti do të mbulojë shpenzimet operative të Komunitetit të Transportit që janë të nevojshme për funksionimin e institucioneve të veta. Shpenzimet e secilit institucion do të caktohen në një pjesë të ndryshme të buxhetit. Komiteti Rajonal Drejtues do të miratojë një vendim që të specifikojë procedurën për realizimin e buxhetit, për paraqitjen dhe auditimin e llogarive dhe inspektimin e tij.



Neni 36

Drejtori dhe Sekretariati i Përhershëm do të zbatojnë buxhetin dhe do të raportojnë mbi bazë vjetore te Komiteti Rajonal Drejtues mbi realizimin e buxhetit. Komiteti Rajonal Drejtues, nëse është e përshtatshme, mund të vendosë t'u besojë audituesve të pavarur verifikimin e realizimit të saktë të buxhetit.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 37

1. Çdo Palë kontraktuese mund të paraqesë para Komitetit Rajonal Drejtues një çështje në konflikt që lidhet me zbatimin apo interpretimin e këtij Traktati, përveçse në rastet kur parashtrohen procedura specifike në këtë Traktat.

2. Kur një mosmarrëveshje është paraqitur para Komitetit Rajonal Drejtues sipas paragrafit 1, do të kryhen konsultime të menjëhershme ndërmjet palëve në mosmarrëveshje. Në rastet kur Bashkimi Evropian nuk është palë në mosmarrëveshje, mund të ftohet nga njëra prej palëve në mosmarrëveshje një përfaqësues i Bashkimit Evropian në këto konsultime. Palët në mosmarrëveshje mund të përpilojnë një propozim për zgjidhje, që në mënyrë të menjëhershme mund t'i paraqitet Komitetit Rajonal Drejtues. Vendimet e marra nga Komiteti Rajonal Drejtues nën këtë procedurë do të respektojnë ligjin bazuar në rastet e Gjykatës së Drejtësisë.

3. Nëse Komiteti Rajonal Drejtues, katër muaj pas kësaj date kur çështja është paraqitur para tij, nuk ka arritur të marrë një vendim për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, palët në mosmarrëveshje mund t'i referohen Gjykatës së Drejtësisë, vendimi i së cilës do të jetë i formës së prerë dhe detyrues. Modalitetet, sipas të cilave mund të bëhen këto referime te Gjykata e Drejtësisë, përcaktohen në aneksin IV.

Dhënia e informacionit

Neni 38

1. Të gjitha organet e ngritura nga ose nën këtë Traktat do të sigurojnë transparencën më të gjerë të mundshme në punën e tyre. Në funksion të kësaj, çdo qytetar i Palëve kontraktuese dhe çdo person juridik apo fizik që banon ose ka regjistruar zyrën e vet në një Palë kontraktuese, do të ketë të drejtën të ketë akses në dokumentet që mbahen nga organet

e ngritura nga ose nën këtë Traktat, të cilat u nënshtrohen parimeve dhe kushteve që do të përcaktohen në përputhje me paragrafin 2.

2. Kufizime dhe parime të përgjithshme mbi baza të interesit publik apo privat që administrojnë këtë të drejtë për akses në dokumente, do të përcaktohen nga Komiteti Rajonal Drejtues nëpërmjet rregullave bazuar në rregullat e BE-së për aksesin në dokumente, referuar Rregullores (KE) nr. 1049/2001 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit*. Rregullat që do të nxirren nga Komiteti Rajonal Drejtues do të mundësojnë një procedurë administrative ku refuzimet për të dhënë akses te një dokument mund të rishikohen dhe të rishqyrtohen.

3. Në masën që dokumentet e mbajtura nga organet e ngritura nga ose nën këtë Traktat përmbajnë informacion mjedisor, siç përcaktohet në nenin 2, pika 3 e Konventës mbi Aksesin në Informacion, Pjesëmarrja Publike në Vendimmarrje dhe Akses në Drejtësi për Çështjet Mjedisore, do të sigurohet akses në këtë informacion në përputhje me nenin 4 të kësaj Konvente.

Komiteti Rajonal Drejtues do të nxjerrë rregullat e nevojshme për të siguruar zbatimin e këtij paragrafi. Ata që zbatojnë rregullat do të mundësojnë një procedurë administrative, ku refuzimet për të dhënë akses te një informacion mjedisor mund të rishikohen dhe të rishqyrtohen.

4. Përfaqësuesve, delegatëve dhe ekspertëve të Palëve kontraktuese, si dhe zyrtarëve dhe nëpunësve të tjerë që veprojnë nën këtë Traktat, do t'u kërkohet, edhe pasi detyrat e tyre të kenë përfunduar, të mos japin informacion që mbulohet nga detyrimi i konfidencialitetit profesional, në veçanti informacion për sipërmarrjet, marrëdhëniet e tyre të biznesit apo komponentët e kostove të tyre.

Vendet e treta dhe organizatat ndërkombëtare

Neni 39

1. Palët kontraktuese do të konsultohen me njëra-tjetrën në kuadrin e Komitetit Rajonal Drejtues me kërkesë të çdonjëres prej Palëve kontraktuese:

* Rregullore (KE) nr. 1049/2001 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 30 maj 2001, lidhur me aksesin publik në dokumentet e Parlamentit Evropian, Këshillit dhe Komisionit Evropian, OJ L 145, 31.5.2001, f. 43.



a) Mbi çështjet e transportit që shqyrtohen në organizatat ndërkombëtare dhe iniciativat rajonale; dhe

b) Mbi aspekte të ndryshme të zhvillimeve të mundshme në marrëdhëniet ndërmjet Palëve kontraktuese dhe vendeve të treta në transport, dhe mbi funksionimin e elementeve të rëndësishme të marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe në këtë fushë.

2. Konsultimet e referuara në paragrafin 1 do të kryhen në rastet urgjente sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast tjetër, brenda tre muajve nga kërkesa.

Marrëveshje të përkohshme

Neni 40

1. Protokollet I deri VI përcaktojnë dispozitat e përkohshme dhe periudhat korresponduese që zbatohen ndërmjet Bashkimit Evropian nga njëra anë dhe Palës së Evropës Juglindore të interesuar nga ana tjetër.

2. Kalimi gradual i secilës Palë të Evropës Juglindore drejt aplikimit të plotë të Komunitetit të Transportit do të jetë objekt i vlerësimeve. Vlerësimet do të kryhen nga Komisioni Evropian në bashkëpunim me Palët e Evropës Juglindore në fjalë. Komisioni Evropian mund të fillojë një vlerësim bazuar në iniciativën e vet ose iniciativën e Palës së Evropës Juglindore të interesuar.

3. Nëse Bashkimi Evropian përcakton se kushtet janë përbushur, ai do të informojë Komitetin Rajonal Drejtues dhe do të vendosë më tej se Pala e Evropës Juglindore e interesuar kualifikohet për të kaluar fazën tjetër të Komunitetit të Transportit.

4. Nëse Bashkimi Evropian përcakton se kushtet nuk janë përbushur, Komisioni Evropian do ta raportojë te Komiteti Rajonal Drejtues. Bashkimi Evropian do t'i rekomandojë Palës së Evropës Juglindore së interesuar përmirësimet specifike.

HYRJA NË FUQI, RISHIKIMI, PËRFUNDIMI DHE DISPOZITA TË TJERA

Neni 41

Hyrja në fuqi

1. Ky Traktat do t'i nënshtrohet ratifikimit ose miratimit nga nënshkruesit, në përputhje me procedurat e tyre. Instrumentet e ratifikimit apo

të miratimit do të depozitohen te Sekretariati i Përhershëm i Këshillit të Bashkimit Evropian, i cili do të njoftojë të gjithë nënshkruesit e tjerë dhe do të kryejë të gjitha funksionet e tjera të depozitarit.

2. Ky Traktat do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit të dytë pas datës së depozitimit të instrumenteve të ratifikimit apo të miratimit nga Bashkimi Evropian dhe të paktën katër Palë të Evropës Juglindore. Për secilin nga nënshkruesit që ratifikon apo miraton këtë Traktat pas kësaj date, do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit të dytë pas depozitimit nga ky nënshkrues të instrumentit të ratifikimit apo miratimit.

3. Pavarësisht paragrafëve 1 dhe 2, Bashkimi Evropian dhe të paktën tre Palë të Evropës Juglindore mund të vendosin që të zbatojnë përkohësisht këtë Traktat ndërmjet tyre që nga data e nënshkrimit, në përputhje me zbatimin e legjislacionit vendës, duke njoftuar depozitarin, i cili do të njoftojë për këtë të gjitha Palët e tjera kontraktuese.

Neni 42

Rishikimi

Ky Traktat do të rishikohet me kërkesë të secilës Palë kontraktuese dhe, në çdo rast, pesë vjet pas hyrjes në fuqi të tij.

Neni 43

Përfundimi

1. Secila Palë kontraktuese mund të denoncojë këtë Traktat duke njoftuar depozitarin, i cili do të njoftojë për këtë përfundim Palët e tjera kontraktuese. Nëse ky Traktat denoncohet nga Bashkimi Evropian, ai do pushojë së qeni në fuqi një vit pas datës së njoftimit. Nëse ky Traktat denoncohet nga çdonjëra prej Palëve të Evropës Juglindore, ai do pushojë së qeni në fuqi vetëm në lidhje me këtë Palë kontraktuese një vit pas datës së njoftimit.

2. Pas hyrjes së një Pale të Evropës Juglindore në Bashkimin Evropian, ajo Palë kontraktuese automatikisht do të pushojë së qeni një Palë e Evropës Juglindore sipas këtij Traktati dhe në vend të kësaj do të bëhet shtet anëtar i BE-së.



Neni 44
Gjuhët

Ky Traktat hartohet në një kopje të vetme origjinale në gjuhët zyrtare të institucioneve të Bashkimit Evropian dhe të Palëve të Evropës Juglindore dhe secili prej këtyre teksteve ka vlerë autentike të barabartë.

Në dëshmi të kësaj, përfaqësuesit fuqiptotë të nënshkruar që janë autorizuar për këtë sipas ligjit, kanë nënshkruar këtë Traktat:

Bërë në:

Për Bashkimin Evropian:

Për Republikën e Shqipërisë:

Për Bosnjën dhe Hercegovinën:

Për Republikën ish-Jugosllave të Maqedonisë:

Për Kosovën*:

Për Malin e Zi:

Për Republikën e Serbisë:

ANEKSI I

RREGULLAT QË ZBATOHEN NË SEKTORIN E TRANSPORTIT DHE ÇËSHTJE QË LIDHEN ME TO

ANEKSI I.1

RREGULLAT QË ZBATOHEN NË INFRASTRUKTURËN E TRANSPORTIT QË KRIJOJNË RRJETIN KRYESOR TË EVROPËS JUGLINDORE

“Dispozitat e zbatueshme” të akteve të mëposhtme të Bashkimit Evropian do të jenë të zbatueshme në përputhje me Traktatin dhe aneksin II mbi përshtatjet horizontale, përveçse në rastet kur specifikohet ndryshe në këtë aneks ose në protokollet I deri VI në vijim. Në rastet kur është e nevojshme, në këtë dokument bëhen përshtatje specifike për çdo akt të veçantë.

Aktet më poshtë të Bashkimit Evropian i referohen versionit më të fundit të këtyre akteve pas ndryshimeve të fundit.

Sfera rregullatore	Legjislacioni
Zhvillimi i rrjetit TEN-T	Rregullorja (BE) nr. 1315/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 11 dhjetor 2013, mbi udhëzimet e Bashkimit për zhvillimin e rrjetit të transportit trans-evropian dhe që shfuqizon vendimin nr. 661/2010/BE, OJ BE L 348, 20.12.2013, f. 1. Rregullore e Deleguar e Komisionit (BE) 2016/758 , e datës 4 shkurt 2016, që ndryshon Rregulloren (BE) nr. 1315/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me përshtatjen me të të aneksit III, OJ BE L 126, 14.5.2016, f. 3.

*Ky përcaktim nuk cenon pozicionet mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën UNSCR 1244/1999 dhe Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.



HARTAT E ZGJATIMIT INDIKATIV TEN-T NË BALLKANIN PERËNDIMOR
(RRJETI KRYESOR DHE AI GJITHËPËRFSHIRËS)



Indicative Extension to Neighbouring Countries
Comprehensive & Core Network: Inland waterways and ports
Western Balkans Region



Core	Comprehensive	Core
Inland Waterways / Completed	Ports	Ports
Inland Waterways / To be upgraded		
Inland Waterways / Planned		

TENtec



Indicative Extension to Neighbouring Countries
 Comprehensive Network: Railways, ports and rail-road terminals (RRT)
 Core Network: Railways (freight), ports and rail-road terminals (RRT)
Western Balkans Region



Comprehensive		Core		Comprehensive		Core	
Conventional rail / Completed	Conventional rail / To be upgraded	High speed rail / Completed	To be upgraded to high speed rail	Ports	RRT	Ports	RRT
Conventional rail / Planned	High speed rail / Planned	High speed rail / Planned	High speed rail / Planned				

TEBtec



Indicative Extension to Neighbouring Countries
 Comprehensive Network: Railways and airports
 Core Network: Railways (passengers) and airports
Western Balkans Region



Comprehensive Core		Comprehensive Core		Comprehensive Core	
	Conventional rail / Completed		High speed rail / Completed		
	Conventional rail / To be upgraded		To be upgraded to high speed rail		
	Conventional rail / Planned		High speed rail / Planned		

TENtec



Indicative Extension to Neighbouring Countries
 Comprehensive & Core Network: Roads, ports, rail-road terminals and airports
Western Balkans Region



Comprehensive		Core		Comprehensive		Core	
Road / To be upgraded	Road / Completed	Ports	Ports	Airports	Airports	RRT	RRT
Road / Planned	Road / To be upgraded						

TENtec



ANEKSI I.2
RREGULLAT QË ZBATOHEN PËR TRANSPORTIN HEKURUDHOR

<p>“Dispozitat e zbatueshme” të akteve të mëposhtme të Bashkimit Evropian do të jenë të zbatueshme në përputhje me Traktatin dhe aneksin II mbi përshtatjet horizontale, përveçse në rastet kur specifikohet ndryshe në këtë aneks ose në protokollet I deri VI në vijim. Në rastet kur është e nevojshme, bëhen në këtë dokument përshtatje specifike për çdo akt të veçantë.</p> <p>Aktet e mëposhtme të Bashkimit Evropian i referohen versionit më të fundit të këtyre akteve pas ndryshimeve të fundit.</p>	
Sfera rregullatore	Legjislacioni
Shërbimet e informacionit lumor (RIS)	Direktiva 2005/44/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 7 shtator 2005, mbi shërbime të harmonizuara të shërbimeve të informacionit lumor - RIS) në transportin ujqor të brendshëm në Komunitet, OJ L 255, 30.9.2005, f. 152. Rregullore Zbatuese e Komisionit (BE) nr. 909/2013 , e datës 10 shtator 2013, mbi specifikimet teknike për paraqitjen e kartës elektronike dhe sistemin e informacionit për lundrimin e brendshëm, e referuar në Direktivën 2005/44/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, OJ BE L 258, 28.9.2013, f. 1. Rregullore e Komisionit (BE) nr. 164/2010 , e datës 25 janar 2010, mbi specifikimet teknike për raportimin elektronik të anijeve në lundrimin në brendësi të tokës, të referuar në nenin 5, të Direktivës 2005/44/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, mbi harmonizimin e shërbimeve të informacionit lumor mbi rrugët ujore në brendësi të tokës në Komunitet, OJ BE L 57, 6.3.2010, f. 1. Rregullore e Komisionit (KE) nr. 416/2007 , datë 22 mars 2007, lidhur me specifikimet teknike për njoftimet për kapitenë anijeje, siç referohet në nenin 5 të Direktivës 2005/44/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, mbi harmonizimin e shërbimeve të informacionit lumor (RIS) në transportin ujqor të brendshëm në Komunitet, OJ BE L 105, 23.4.2007, f. 88. Rregullore e Komisionit (KE) nr. 415/2007 , e datës 13 mars 2007, lidhur me specifikimet teknike për lokalizimin elektronik dhe sistemet lokalizuese të referuara në nenin 5 të Direktivës 2005/44/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, mbi harmonizimin e shërbimeve të informacionit lumor (RIS) në transportin ujqor të brendshëm në Komunitet, OJ BE L 105, 23.4.2007, f. 35.



	Rregullore e Komisionit (KE) nr. 414/2007 , e datës 13 mars 2007, lidhur me udhëzimet teknike për planifikimin, zbatimin dhe përdorimin operativ të shërbimeve të informacionit lumor (RIS) të referuara në nenin 5 të Direktivës 2005/44/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, mbi harmonizimin e shërbimeve të informacionit lumor (RIS) në transportin ujor të brendshëm në Komunitet, OJ BE L 105, 23.4.2007, f. 1.
Mjedisi	<p>Direktiva 2009/30 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 23 prill 2009, që ndryshon Direktivën 98/70/KE, e cila lidhet me specifikimin e benzinës, naftës dhe gaz-naftës dhe prezantimit të një mekanizmi për të monitoruar dhe për të reduktuar emetimet e gazit me efekt serrë dhe që ndryshon Direktivën e Këshillit 1999/32/KE, lidhur me specifikimet e lëndës djegëse të përdorur nga mjetet lundruese të transportit ujor të brendshëm, me të cilën shfuqizohet Direktiva 93/12/KEE, OJ BE L 140, 5.6.2009, f. 88.</p> <p>Rregullore (BE) 2016/1628 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 14 shtator 2016, për kërkesat lidhur me kufizimin e emetimeve gazore dhe grimcave ndotëse, si edhe për miratimin e modelit në rast të motorëve me djegie të brendshme, që do të instalohen në makineri të lëvizshme që drejtojnë jashtë rruge, më të cilën ndryshohen Rregulloret (BE) nr. 1024/2012 dhe 167/2013, dhe me të cilën modifikohet dhe shfuqizohet Direktiva 97/68/KE (OJ BE L 252, 16.9.2016, f. 53).</p> <p>Direktiva 97/68/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 dhjetor 1997, mbi përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare, lidhur me masat kundër nxjerrjes së ndotësve të gaztë dhe grimcave ndotëse nga motorët me djegie të brendshme, që do të instalohen në makineri të lëvizshme që drejtojnë jashtë rruge, OJ BE L 59, 27.2.1998, f. 1 (megjithatë, shihni nenin 64 të Rregullores (BE) 2016/1628).</p> <p>Direktiva 2004/26/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 21 prill 2004, që ndryshon Direktivën 97/68/KE, mbi përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare, lidhur me masat kundër nxjerrjes së ndotësve të gaztë dhe grimcave ndotëse nga motorët me djegie të brendshme, që do të instalohen në makineri të lëvizshme që drejtojnë jashtë rruge, OJ BE L 146, 30.4.2004, f. 1.</p>
Transporti ujor i brendshëm dhe detar	Rregullore (BE) nr. 1177/2010 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 24 nëntor 2010, lidhur me të drejtat e pasagjerëve kur udhëtojnë në det dhe ujërat e brendshme dhe që ndryshon Rregulloren (KE) nr. 2006/2004, OJ BE L 334, 17.12.2010, f. 1.

ANEKSI I.6

RREGULLAT MJEDISORE TË ZBATUESHME NË SEKTORIN E TRANSPORTIT

<p>“Dispozitat e zbatueshme” të akteve të mëposhtme të Bashkimit Evropian do të jenë të zbatueshme në përputhje me Traktatin dhe aneksin II mbi përshtatjet horizontale, përveç në rastet kur specifikohet ndryshe në këtë aneks ose në protokollet I deri VI në vijim. Në rastet kur është e nevojshme, në këtë dokument bëhen përshtatje specifike për çdo akt të veçantë.</p> <p>Aktet e mëposhtme të Bashkimit Evropian i referohen versionit më të fundit të këtyre akteve pas ndryshimeve të fundit.</p>	
Sfera rregullatore	Legjislacioni
Vlerësimi i ndikimeve	<p>Direktiva 2011/92/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 dhjetor 2011, mbi vlerësimin e efekteve të projekteve të caktuara publike e private mbi mjedisin, OJ BE L 026, 28.1.2012, f. 1,</p> <p>dhe Konventa ESPOO.</p> <p>Të gjitha projektet që hyjnë në objektin e këtij Traktati do të jenë subjekt i një vlerësimi të ndikimit mjedisor, në përputhje me standardet e BE-së. Gjithashtu, duhen trajtuar aspekte trans-kufitare, në përputhje me kërkesat e Konventës ESPOO.</p> <p>Direktiva 2001/42/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 27 qershor 2001, mbi vlerësimin e efekteve të planeve dhe programeve të caktuara mbi mjedisin, OJ KE L 197, 21.7.2001, f. 30.</p> <p>Protokolli SEA për Konventën ESPOO.</p> <p>Të gjitha planet dhe programet në fushën e transportit, në rastet kur është e zbatueshme, do të jenë subjekt i një vlerësimi mjedisor të ngjashëm me atë që parashikohet në Direktivën SEA (Vlerësimi strategjik mjedisor). Gjithashtu, duhen trajtuar aspektet ndërkufitare në përputhje me kërkesat e protokollit SEA për Konventën ESPOO.</p>



Ruajtja	Direktiva e Këshillit 92/43/KEE , e datës 21 maj 1992, mbi ruajtjen e habitateve natyrore dhe të florës dhe faunës së egër, OJ KE L 206, 22.7.1992, f. 7. Nëse një projekt mund të shkaktojë një ndikim në vende me rëndësi për ruajtjen e natyrës, do të kryhet një vlerësim i përshtatshëm i natyrës, i barasvlershëm me atë që përcaktohet në nenin 6 të Direktivës për Habitatet.
Lëndët djegëse	Direktiva 98/70/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 13 tetor 1998, mbi cilësinë e lëndëve djegëse të benzinës dhe naftës dhe që ndryshon Direktivën e Këshillit 93/12/KEE, OJ KE L 350 28.12.1998, f. 58. Direktiva (BE) 2016/802 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 maj 2016, mbi një reduktim në përmbajtjen e sulfurit të lëndëve djegëse, të caktuara të lëngëta, OJ BE L 132, 21.5.2016, f. 58.
Politikat për ujin	Direktiva 2000/60/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 23 tetor 2000, që krijon kuadrin për veprim të Komunitetit në fushën e politikës ujore, OJ KE L 327, 22.12.2000, f. 1. Të gjitha projektet e transportit mbi lundrimin që hyjnë në objektin e këtij Traktati duhet të zhvillohen dhe të zbatohen në përputhje me dispozitat e nenit 4.7 të Direktivës 2000/60/KE. Të gjitha projektet mbi lundrimin që hyjnë në objektin e këtij Traktati, në rastet kur është e zbatueshme, duhet të kryhen në përputhje me Deklaratën e Përbashkët mbi Lundrimin në terrenin tokësor dhe Qëndrueshmërinë Mjedisore në Basenin e Lumit të Danubit, siç mbështetet nga Komisioni Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Lumit të Danubit - ICPDR, Komisioni i Danubit dhe Komisioni i Savës.

ANEKSI I.7

RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK TË ZBATUESHME NË SEKTORIN E TRANSPORTIT

<p>“Dispozitat e zbatueshme” të akteve të mëposhtme të Bashkimit Evropian do të jenë të zbatueshme në përputhje me Traktatin dhe aneksin II, mbi përshtatjet horizontale, përveç në rastet kur specifikohet ndryshe në këtë aneks ose në protokollet I deri VI në vijim. Në rastet kur është e nevojshme, në këtë dokument bëhen përshtatje specifike për çdo akt të veçantë.</p> <p>Aktet e mëposhtme të Bashkimit Evropian i referohen versionit më të fundit të këtyre akteve pas ndryshimeve të fundit.</p>	
Sfera rregullatore	Legjislacioni
Procedurat e rishikimit	<p>Direktiva e Këshillit 89/665/KEE, e datës 21 dhjetor 1989, mbi koordinimin e ligjeve, rregullores dhe dispozitave administrative, që lidhen me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënie kontratave të punëve publike dhe furnizimit publik, OJ KE L 395 30.12.1989, f. 33.</p> <p>Direktiva e Këshillit 92/13/KEE, e datës 25 shkurt 1992, që koordinon ligjet, rregulloren dhe dispozitat administrative që lidhen me zbatimin e rregullave të Komunitetit, mbi procedurat e prokurimit të njësisve që drejtojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe telekomunikacionit, OJ KE L 076 23.3.1992, f. 14.</p>
Procedurat e prokurimit	<p>Direktiva 2014/23/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 26 shkurt 2014, mbi dhënie kontratave të koncesioneve, OJ BE L 094 28.3.2014, f. 1.</p> <p>Direktiva 2014/24/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 26 shkurt 2014, mbi prokurimin publik dhe që shfuqizon Direktivën 2004/18/KE, OJ BE L 094 28.3.2014, f. 65.</p> <p>Direktiva 2014/25/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 26 shkurt 2014, mbi prokurimin nga njësitë që drejtojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare dhe që shfuqizon Direktivën 2004/17/KE, OJ BE L 094 28.3.2014, f. 243.</p> <p>Rregullore Zbatuese e Komisionit(BE) 2015/1986, e datës 11 nëntor 2015, që ndërton format standarde për botimin e shënimeve në fushën e prokurimit publik dhe që shfuqizon Rregullore Zbatuese (BE) nr. 842/2011, OJ BE L 296, 12.11.2015, f. 1.</p>
Shërbimet publike	Rregullore (KE) nr. 1370/2007 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 23 tetor 2007, mbi shërbimet publike të transportit rrugor dhe hekurudhor të dhe që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KEE) nr. 1191/69 dhe 1107/70, OJ BE L 315, 3.12.2007, f. 1.



ANEKSI II
PËRSHTATJE HORIZONTALE DHE
RREGULLA TË CAKTUARA
PROCEDURALE

Dispozitat e akteve të specifikuar në aneksin I do të jenë të zbatueshme në përputhje me Marrëveshjen kryesore dhe paragrafët 1–3 të këtij aneksi, përveçse në rastet kur specifikohet ndryshe në aneksin I. Përshtatjet specifike të nevojshme për aktet e veçanta përcaktohen në aneksin I.

Ky Traktat do të zbatohet në pajtim me rregullat procedurale të përcaktuara në paragrafët 4 dhe 6 të këtij aneksi.

1. PJESËT PREZANTUESE TË AKTEVE

Preambulat e akteve të specifikuar nuk janë përshtatur për qëllimet e këtij Traktati. Ato janë përkatëse deri në shkallën që është e nevojshme për interpretimin dhe aplikimin e tyre të duhur, brenda kuadrit të këtij Traktati, të dispozitave që përmbahen në këto akte.

2. TERMINOLOGJIA SPECIFIKE E AKTEVE

Termet e mëposhtëm të përdorur nga aktet e specifikuar në aneksin I do të lexohen si vijon:

a) Termi “Komuniteti Evropian”, “Komuniteti”, “Bashkimi Evropian” dhe “Bashkimi” do të lexohen “Zona Komunitare e Transportit”;

b) Termet “Ligji komunitar”, “Legjislacioni komunitar”, “Instrumente komunitare”, “Ligji i Bashkimit”, “Legjislacioni i Bashkimit”, “Instrumente të Bashkimit” dhe “Traktati” kur i referohen Traktatit mbi Bashkimin Evropian ose Traktatit mbi funksionimin e Bashkimit Evropian do të lexohen “Traktati Komunitar i Transportit”;

c) Termi “infrastrukturë hekurudhore” do të lexohet “infrastrukturë hekurudhore në Zonën Komunitare të Transportit”;

d) Termi “infrastrukturë rrugore” do të lexohet “infrastrukturë rrugore në Transport Sfera e Komunitetit”;

e) Termi “infrastrukturë aeroporti” do të lexohet “infrastrukturë aeroporti në Zonën Komunitare të Transportit”;

f) Termi “infrastrukturë e rrugëve ujore tokësore” do të lexohet “infrastrukturë e rrugëve ujore tokësore e Zonës Komunitare të Transportit”;

g) Termi “Gazeta Zyrtare e Komuniteteve Evropiane” ose “Gazeta Zyrtare e Bashkimit

Evropian” do të lexohet “Gazetat Zyrtare të Palëve Kontraktuese”.

3. REFERENCAT PËR SHTETET ANËTARE

Pa kundërshti për pikën 4 të këtij aneksi, kurdo që aktet e specifikuar në aneksin I përmbajnë referenca për “Shtet/Shtete Anëtare”, referencat do të kuptohen që përfshijnë, përveç Shtetet Anëtare të BE-së, edhe Palët e Evropës Juglindore.

4. DISPOZITAT E KOMITETEVE TË BASHKIMIT DHE KONSULTIMI ME PALËT E EVROPËS JUGLINDORE

Ekspertëve të Palëve të Evropës Juglindore do t’u mundësohen konsulta nga Komisioni Evropian dhe do t’u jepet mundësia që të paraqesin këshillat e tyre çdo herë që aktet e specifikuar në aneksin I përcaktojnë mundësinë për konsultime të Komisionit Evropian me Komitetet e Bashkimit Evropian dhe për mundësinë për të paraqitur këshillat ose opinionet e tyre.

Çdo konsultim do të konsistojë në një takim të kryesuar nga Komisioni Evropian dhe do të kryhet brenda Komitetit Rajonal Drejtues, me ftesë të Komisionit Evropian, para konsultimeve të Komitetit përkatës të Bashkimit Evropian. Komisioni Evropian do të njoftojë secilën Palë të Evropës Juglindore të paktën dy jave para takimit, përveçse në rastet kur kushtet specifike kërkojnë një njoftim në afat më të shkurtër, me të gjithë informacionin e nevojshëm.

Palët e Evropës Juglindore do të ftohen të paraqesin pikëpamjet e tyre para Komisionit Evropian. Komisioni Evropian do t’u kushtojë vëmendjen e duhur këshillave të përcjella nga Palët e Evropës Juglindore.

Dispozitat e mësipërme nuk do të zbatohen për zbatimin e rregullave të konkurrencës të përcaktuara në këtë Traktat, të cilat do të administrohen nga procedura konsultimi të veçanta të përcaktuara në aneksin III.

5. BASHKËPUNIMI DHE SHKËMBIMI I INFORMACIONIT

Për të lehtësuar dhe për të koordinuar ushtrimin e kompetencave përkatëse të autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese, autoritete të tilla, në bazë të kërkesës, do të shkëmbejnë të gjithë informacionin e nevojshëm për funksionimin e duhur të këtij Traktati.



6. REFERENCA PËR GJUHËT

Palët Kontraktuese do të kenë të drejtë të përdorin, në procedurat e përcaktuara në sferën e këtij Traktati dhe pa kundërshti ndaj aneksit IV, çdo gjuhë zyrtare të institucioneve të Bashkimit Evropian apo të një Palë tjetër Kontraktuese. Megjithatë, Palët Kontraktuese janë të ndërgjegjshme se përdorimi i gjuhës angleze i lehtëson këto procedura. Nëse një gjuhë që nuk është gjuhë zyrtare e institucioneve të Bashkimit Evropian përdoret në një dokument zyrtar, do të paraqitet në mënyrë simultane një përkthim në një gjuhë zyrtare të institucioneve të Bashkimit Evropian, duke pasur parasysh dispozitën e fjalisë pararendëse. Nëse një Palë Kontraktuese synon të përdorë, në një procedurë komunikimi gojor, një gjuhë që nuk është gjuhë zyrtare e institucioneve të Bashkimit Evropian, Pala Kontraktuese do të sigurojë përkthim simultan në anglisht.

ANEKSI III

RREGULLAT MBI KONKURRENCËN DHE NDIHMËN SHETËTËRORE TË REFERUAR NË NENIN 17 TË TRAKTATIT KRYESOR

Neni 1

Monopolet shtetërore

Një Palë e Evropës Juglindore do të përshtatë në mënyrë progresive çdo monopol shtetëror të një karakteri tregtar, në mënyrë që të sigurojë se nga fundi i periudhës së dytë të referuar në Protokollin e këtij Traktati që përmban masa të përkohshme në lidhje me Palën e Evropës Juglindore të interesuar, të mos ekzistojë midis qytetarëve të Palëve Kontraktuese, asnjë diskriminim në lidhje me kushtet nën të cilat prokurohen dhe tregohen mallrat. Komiteti Rajonal Drejtues do të informohet për masat e marra për të arritur këtë objektiv.

Neni 2

Përafrimi i legjislacionit mbi ndihmën shtetërore dhe konkurrencën

1. Palët Kontraktuese e njohin rëndësinë e përafrimit nga ana e Palëve të Evropës Juglindore të legjislacionit ekzistues mbi ndihmën shtetërore dhe konkurrencën me atë të Bashkimit Evropian. Palët e Evropës Juglindore do të bëjnë përpjekje të sigurojnë se ligjet e tyre ekzistuese dhe në të ardhmen mbi ndihmën shtetërore dhe

konkurrencën të bëhen gradualisht të pajtueshme me kuadrin ligjor të BE-së - *acquis*.

2. Ky përafrim do të fillojë me hyrjen në fuqi të këtij Traktati dhe do të shtrihet gradualisht te të gjitha elementet e dispozitave në Bashkimin Evropian mbi ndihmën shtetërore dhe konkurrencën, e referuar në këtë Aneks, deri nga fundi i periudhës së dytë të referuar në Protokollin e këtij Traktati që përmban masa të përkohshme në lidhje me Palën e Evropës Juglindore të interesuar. Pala e Evropës Juglindore të interesuar do të përcaktojë gjithashtu, në marrëveshje me Komisionin Evropian, modalitetet për monitorimin e zbatimit të përafrimit të legjislacionit dhe për veprimet që do të ndërmerren në funksion të zbatimit dhe ushtrimit të ligjeve.

Neni 3

Rregullat e konkurrencës dhe dispozita të tjera ekonomike

1. Praktikrat e mëposhtme nuk janë të pajtueshme me funksionimin e duhur të këtij Traktati, në masën që mund të kenë ndikim në tregtinë ndërmjet dy apo më shumë Palëve Kontraktuese:

i) të gjitha marrëveshjet ndërmjet sipërmarrjeve, vendime nga shoqatat e sipërmarrësve dhe praktikrat e drejtuara ndërmjet sipërmarrjeve, që kanë si objekt të tyre ose për qëllim të tyre, parandalimin, kufizimin apo shtrembërimin e konkurrencës;

ii) abuzim nga një apo më shumë sipërmarrje në një pozicion dominues në territoret e Palëve Kontraktuese në tërësi ose si një pjesë thelbësore e tyre;

iii) çdo ndihmë shtetërore që shtrembëron apo kërcënon të shtrembërojë konkurrencën, duke favorizuar sipërmarrje apo produkte të caktuara.

2. Çdo praktikë në kundërshtim me këtë nen do të vlerësohet mbi bazën e kriterëve që rrjedhin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës që zbatohen në Bashkimin Evropian, në veçanti nga nenet 93, 101, 102, 106, 107 dhe 108 të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian dhe instrumentet interpretuese të miratuara nga institucionet e Bashkimit Evropian.

3. Çdo Palë e Evropës Juglindore do të garantojë se një organi publik të pavarur nga pikëpamja operationale, i besohet autoritetet i nevojshëm për zbatimin e plotë të paragrafit 1(i)



dhe (ii), në lidhje me sipërmarrjet publike dhe private dhe sipërmarrjet, të cilave u janë dhënë të drejta të veçanta.

4. Çdo Palë e Evropës Juglindore do të caktojë ose do të ngrëjë një autoritet të pavarur nga pikëpamja operationale, të cilit i besohet autoriteti i nevojshëm për zbatimin e plotë të paragrafit 1(iii). Ky autoritet do të ketë, ndër të tjera, autoritet të autorizojë skema të ndihmës shtetërore dhe grante ndihme individuale, në përputhje me paragrafin 2, si dhe kompetencat me qëllim që të kompensojë ndihmën shtetërore që është dhënë në mënyrë të paligjshme.

5. Çdo Palë Kontraktuese do të sigurojë transparencë në sferën e ndihmës shtetërore, ndër të tjera, duke u dhënë Palëve të tjera Kontraktuese një raport të rregullt vjetor ose të barasvlerëshëm me të, duke ndjekur metodologjinë dhe prezantimin e studimit të Bashkimit Evropian mbi ndihmën shtetërore. Me kërkesë nga një Palë Kontraktuese, Pala tjetër Kontraktuese do të japë informacion mbi raste individuale të veçanta të ndihmës publike.

6. Çdo Palë e Evropës Juglindore do të hartojë një inventar të plotë gjithëpërfshirës të skemave të ndihmës së formalizuar para ngritjes së autoritetit të referuar në paragrafin 4 dhe do t'i harmonizojë skema të tilla ndihme me kriteret e referuara në paragrafin 2.

7.

a) Me synimet për të zbatuar dispozitat e paragrafit 1(ii), Palët Kontraktuese e pranojnë faktin se gjatë periudhave të referuara në Protokollin e këtij Traktati që përmban masa të përkohshme në lidhje me një Palë të Evropës Juglindore, çdo ndihmë publike e dhënë nga kjo Palë e Evropës Juglindore do të vlerësohet duke marrë në konsideratë se Pala e Evropës Juglindore e interesuar duhet të konsiderohet si një zonë identike me ato zona të Bashkimit Evropian, ku standardi i jetesës është tej mase i ulët ose ku ka papunësi serioze siç referohet në nenin 107(3)(a) të Traktatit mbi Funkcionimin e Bashkimit Evropian.

b) Nga fundi i periudhës së parë të referuar në Protokollin e këtij Traktati që përmban masa të përkohshme në lidhje me një Palë të Evropës Juglindore, kjo Palë do t'i paraqesë Komisionit Evropian shifrat e saj të PBB-së për banor, të harmonizuara në nivelin NUTS II. Autoriteti i referuar në paragrafin 4 dhe Komisioni Evropian, në mënyrë të përbashkët, do të vlerësojnë më tej

përshtatshmërinë e rajoneve të Palës së Evropës Juglindore të interesuar, si dhe intensitetet maksimale të ndihmave në lidhje me to, me qëllim që të përpilohet harta rajonale e ndihmave mbi bazë të udhëzimeve përkatëse të Bashkimit Evropian.

8. Nëse një nga Palët Kontraktuese çmon se një praktikë e veçantë është e papajtueshme me kushtet e paragrafit 1, ajo mund të marrë masat e duhura pas konsultimit brenda Komitetit Rajonal Drejtues ose tridhjetë ditë pune pas referimit për këtë konsultim.

9. Palët Kontraktuese do të shkëmbejnë informacion, duke marrë në konsideratë kufizimet e vendosura nga kërkesat e konfidencialitetit profesional dhe tregtar.

ANEKSI IV

REFERIMET TE GJYKATA E DREJTËSISË E BASHKIMIT EVROPIAN

1. Parimet e përgjithshme në lidhje me nenin 19 të Traktatit Kryesor

1. Dispozitat e Statutit të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian, që në vijim në këtë dokument do të referohen si “Gjykata e Drejtësisë” dhe të rregullave të saj të procedurës lidhur me referimet për vendimet paraprake, do të zbatohen, në masën që janë të përshtatshme, për kërkesat për vendim paraprak të paraqitura nga një gjykatë apo tribunal i një Pale të Evropës Juglindore, në bazë të nenit 19 të Traktatit Kryesor.

2. Në këto raste, Palët e Evropës Juglindore do të kenë brenda sferës së këtij Traktati, të njëjtat të drejta për të paraqitur vërejtjet te Gjykata e Drejtësisë, ashtu si Shtetet Anëtare të BE-së.

2. Shkalla dhe modalitetet e procedurës së përcaktuar në nenin 19 të Traktatit Kryesor

1. Kur, në përputhje me paragrafin e dytë të nenit 19, një Palë e Evropës Juglindore miraton një vendim mbi shkallën dhe modalitetet e referimeve te Gjykata e Drejtësisë, ky vendim do të specifikojë se, ose:

a) Çdo gjykatë apo tribunal i Palës së Evropës Juglindore kundër vendimeve të së cilës nuk ka rregullim gjyqësor nën ligjin kombëtar, do t'i kërkojë Gjykatës së Drejtësisë që të japë një vendim paraprak mbi një çështje që ka dalë para saj në një rast në pritje për procedim lidhur me vlefshmërinë apo interpretimin e këtij Traktati ose një dispozite të referuar në nenin 19, nëse ajo



gjykatë apo ai tribunal çmon se një vendim mbi çështjen është i nevojshëm për t'i bërë të mundur që të japë një vendim; ose

b) Çdo gjykatë apo tribunal i asaj Pale të Evropës Juglindore mund t'i kërkojë Gjykatës së Drejtësisë që të japë një vendim paraprak mbi një çështje që ka dalë para saj lidhur me vlefshmërinë apo interpretimin e këtij Traktati ose një dispozite të referuar në nenin 19, nëse ajo gjykatë apo ai tribunal çmon se një vendim mbi çështjen është i nevojshëm për t'i bërë të mundur që të japë një vendim.

2. Modalitetet e zbatimit të nenit 19 do të bazohen në parimet e mishëruara në dispozitat ligjore që rregullojnë funksionimin e Gjykatës së Drejtësisë, duke përfshirë edhe dispozitat përkatëse të Traktatit mbi Bashkimin Evropian dhe Traktatit mbi funksionimin e Bashkimit Evropian, Statutin dhe Rregullat e Procedurës së Gjykatës së Drejtësisë, si dhe ligjin bazuar në rastet të kësaj të fundit. Në rast kur merr një vendim mbi modalitetet e zbatimit të kësaj dispozite, Pala e Evropës Juglindore do të marrë gjithashtu në konsideratë rekomandimet e nxjerra nga Gjykata e Drejtësisë për tribunalet dhe gjykatat kombëtare në lidhje me fillimin e procedimeve për gjykim paraprak.

3. Mosmarrëveshjet e paraqitura pranë Gjykatës së Drejtësisë, në përputhje me nenin 37(3) të Traktatit Kryesor

Dispozitat e Statutit të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian dhe rregullave të saj të procedurës në lidhje me mosmarrëveshjet paraqitur në Gjykatë, në përputhje me nenin 273 të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian do të zbatohen, në masën që janë të përshtatshme, për mosmarrëveshjet që i janë paraqitur në përputhje me nenin 37(3) të Traktatit Kryesor.

4. Referimet të Gjykata e Drejtësisë dhe gjuhët

Palët e Evropës Juglindore do të kenë të drejtë të përdorin në procedurat para Gjykatës së Drejtësisë, të ngritura në bazë të përcaktimeve në sferën e Traktatit, çdo gjuhë zyrtare të institucioneve të Bashkimit Evropian apo të një Pale të Evropës Juglindore. Nëse një gjuhë që nuk është gjuhë zyrtare e institucioneve të Bashkimit Evropian përdoret në një dokument zyrtar, do të paraqitet në mënyrë simultane një

përkthim në frëngjisht. Nëse një Palë Kontraktuese synon të përdorë në një procedurë verbale, një gjuhë që nuk është gjuhë zyrtare e institucioneve të Bashkimit Evropian, Pala e Evropës Juglindore do të sigurojë përkthim simultan në frëngjisht.

ANEKSI V KONTRIBUTET NË BUXHETIN E KOMUNITETIT TË TRANSPORTIT

Palët	Kontributi në përqindje
Bashkimi Evropian	80,00
Republika e Shqipëria	3,20
Bosnja dhe Hercegovina	3,55
Republika ish-Jugosllave e Maqedonisë	2,88
Kosova*	2,57
Mali i Zi	2,38
Republika e Serbisë	5,42

Kontributi ndahet në dy pjesë: 80% për Bashkimin Evropian dhe 20% për gjashtë (6) për palët nënshkruese nga Evropa Juglindore.

20% për palët nënshkruese nga Evropa Juglindore do të ndahet gjithashtu sipas skemës së mëposhtme: çdo palë nënshkruese kontribuon me 2% në buxhet dhe pjesa e mbetur prej 8% do të shpërndahet mes gjashtë (6) palë nënshkruese nga Evropa Juglindore në përputhje me pjesën e tyre proporcionale të PBB-së në totalin e PBB të Palëve të Evropës Juglindore.

PROTOKOLLI I DISPOZITA TË PËRKOHSHME NDËRMJET BASHKIMIT EUROPIAN NGA NJËRA ANË DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NGA ANA TJETËR

I. Kushtet lidhur me tranzicionin për transportin hekurudhor

Neni 1

1. Periudha e parë e përkohshme do të shtrihet nga hyrja në fuqi e këtij Traktati derisa të jenë përmbushur të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 2(1) të këtij Protokoll nga Republika e Shqipërisë, që në vijim në këtë dokument do të

* Ky përcaktim nuk cenon pozicionet mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën UNSCR 1244/1999 dhe Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mbi deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.



referohet si “Shqipëria”, të verifikuara nga një vlerësim i kryer nga Komisioni Evropian, në përputhje me procedurat e referuara në nenin 40 të Traktatit Kryesor.

2. Periudha e dytë e përkohshme do të shtrihet nga fundi i periudhës së parë të përkohshme derisa të jenë përmbushur nga Shqipëria të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 2(2) të këtij Protokoll, të verifikuara nga një vlerësim i kryer nga Komisioni Evropian në përputhje me procedurat e referuara në nenin 40 të Traktatit Kryesor.

3. Shqipëria mund t'i kërkojë Komisionit Evropian në fund të periudhës së parë të përkohshme që të vlerësojë progresin në përputhje me nenin 40 të Traktatit Kryesor, me synimin që të kalojë drejtpërdrejt tek integrimi i tregut, sipas nenit 11 të Traktatit Kryesor.

Neni 2

1. Nga fundi i periudhës së parë të përkohshme, Shqipëria:

i) Do të ketë zbatuar të gjithë legjislacionin mbi hekurudhat, siç përcaktohet në aneksin I;

ii) Do të ketë bërë progres të mjaftueshëm në zbatimin e rregullave mbi ndihmën shtetërore dhe konkurrencën që përfshihet në një marrëveshje të referuar në nenin 17 të Traktatit Kryesor ose në aneksin III, cilado që të jetë e zbatueshme.

2. Nga fundi i periudhës së dytë të përkohshme, Shqipëria do të zbatojë këtë Traktat, duke përfshirë të gjithë legjislacionin mbi hekurudhat dhe rregullat mbi ndihmën shtetërore dhe konkurrencën e referuar në paragrafin 1.

Neni 3

1. Pavarësisht nenit 1(1) të Traktatit kryesor:

i) Gjatë periudhës së parë të përkohshme, sipërmarrjeve hekurudhore të licencuara në Shqipëri do t'u jepet akses në infrastrukturën hekurudhore në Shqipëri;

ii) Gjatë periudhës së dytë të përkohshme, sipërmarrjet hekurudhore të licencuara në Shqipëri do të lejohen të ushtrojnë të drejtat e trafikut që jepen në legjislacionin hekurudhor të referuar në aneksin I mbi infrastrukturën hekurudhore të çdo Pale tjetër të Evropës Juglindore.

II. Kushtet lidhur me tranzicionin për transportin detar

Neni 1

1. Periudha e parë të përkohshme do të shtrihet nga hyrja në fuqi e këtij Traktati derisa të jenë përmbushur nga Shqipëria të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 2(1) të këtij Protokoll, të verifikuara nga një vlerësim i kryer nga Komisioni Evropian, në përputhje me procedurat e referuara në nenin 40 të Traktatit Kryesor.

2. Periudha e dytë të përkohshme do të shtrihet nga fundi i periudhës së parë të përkohshme derisa të jenë përmbushur nga Shqipëria të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 2(2) të këtij Protokoll, të verifikuara nga një vlerësim i kryer nga Komisioni Evropian, në përputhje me procedurat e referuara në nenin 40 të Traktatit Kryesor.

Neni 2

1. Nga fundi i periudhës së parë të përkohshme:

i) Shqipëria do të ketë zbatuar të gjithë legjislacionin mbi legjislacion detar, siç përcaktohet në aneksin I, me përjashtim të rregullores (KEE) nr. 3577/92;

ii) Qytetarët e Shqipërisë dhe shoqëritë e transportit detar të ngritura në Shqipëri do të gëzojnë të drejtën të transportojnë pasagjerë ose mallra me mjete detare ndërmjet çdo porti të një Shteti Anëtar dhe çdo porti të një Shteti tjetër Anëtar ose të një vendi që nuk është Anëtar i Bashkimit Evropian. Kjo do të zbatohet për shqiptarët dhe shoqëritë shqiptare të transportit detar të Shqipërisë të ngritura jashtë Shqipërisë dhe që kontrollohen nga qytetarë të Shqipërisë, nëse mjetet e tyre detare janë të regjistruara në Shqipëri, në përputhje me legjislacionin e saj.

Në mënyrë reciproke, pronarë anijesh në BE do të gëzojnë të drejtën të transportojnë pasagjerë ose mallra me mjete detare ndërmjet çdo porti ose instalimi larg bregut të një Shteti Anëtar të BE-së dhe të Shqipërisë dhe çdo porti ose instalim larg bregut të një vendi që nuk është Anëtar i Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë. Kjo do të zbatohet për qytetarët e Shteteve Anëtare të BE-së dhe shoqëritë e transportit detar të BE-së, të ngritura jashtë Bashkimit Evropian dhe që kontrollohen nga qytetarë të Shteteve Anëtare të BE-së, nëse mjetet e tyre detare janë të regjistruara në Shtetet Anëtare të BE-së, në përputhje me legjislacionin e tyre.



2. Nga fundi i periudhës së dytë të përkohshme:

i) Shqipëria do të zbatojë këtë Traktat, duke përfshirë të gjithë legjislacionin e përcaktuar në aneksin I;

ii) Pronarë anijesh të BE-së që drejtojnë anije të regjistruara në një Shtet Anëtar të BE-së ose në Shqipëri dhe që mbajnë flamurin e atij Shteti Anëtar apo të Shqipërisë, do të kenë lirinë që të ofrojnë shërbime transporti brenda Shqipërisë dhe nën kushtet e përcaktuara në Rregulloren (KEE) nr. 3577/92.

Në mënyrë reciproke, pronarë anijesh të Shqipërisë që drejtojnë anije të regjistruara në një Shtet Anëtar të BE-së ose në Shqipëri dhe që mbajnë flamurin e atij Shteti Anëtar apo të Shqipërisë do të kenë lirinë që të ofrojnë shërbime transporti brenda çdo Shteti Anëtar të BE-së nën kushtet e përcaktuara në Rregulloren (KEE) nr. 3577/92.

III. Kushtet lidhur me tranzicionin për transportin në rrugët ujore tokësore

Neni 1

1. Periudha e parë e përkohshme do të shtrihet nga hyrja në fuqi e këtij Traktati derisa të jenë përmbushur të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 2 të këtij Protokoll nga Shqipëria, të verifikuara nga një vlerësim i kryer nga Komisioni Evropian, në përputhje me procedurat e referuara në nenin 40 të Traktatit Kryesor.

Neni 2

1. Nga fundi i periudhës së përkohshme:

i) Shqipëria do të zbatojë këtë Traktat, duke përfshirë të gjithë legjislacionin e përcaktuar në aneksin I.

ii) Shqipëria do të gëzojë të drejtën të kryejë transport ujor të brendshëm të pasagjerëve ose të mallrave ndërmjet çdo porti të një Shteti Anëtar dhe çdo porti apo instalimi larg bregut të një Shteti Anëtar tjetër.

PROTOKOLLI II

DISPOZITA TË PËRKOHSHME NDËRMJET BASHKIMIT EVROPIAN NGA NJËRA ANË DHE BOSNJËS DHE HERCEGOVINËS NGA ANA TJETËR

I. Kushtet lidhur me tranzicionin për transportin hekurudhor

Neni 1

1. Periudha e parë e përkohshme do të shtrihet nga hyrja në fuqi e këtij Traktati derisa të jenë përmbushur nga Bosnja dhe Hercegovina të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 2(1) të këtij Protokoll, të verifikuara nga një vlerësim i kryer nga Komisioni Evropian, në përputhje me procedurat e referuara në nenin 40 të Traktatit Kryesor.

2. Periudha e dytë e përkohshme do të shtrihet nga fundi i periudhës së parë të përkohshme derisa të jenë përmbushur nga Bosnja dhe Hercegovina të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 2(2) të këtij Protokoll, të verifikuara nga një vlerësim i kryer nga Komisioni Evropian, në përputhje me procedurat e referuara në nenin 40 të Traktatit Kryesor.

3. Bosnja dhe Hercegovina mund t'i kërkojë Komisionit Evropian në fund të periudhës së parë të përkohshme që të vlerësojë progresin, në përputhje me nenin 40 të Traktatit Kryesor, me synimin që të kalojë drejtpërdrejt tek integrimi i tregut, sipas nenit 11 të Traktatit Kryesor.

Neni 2

1. Nga fundi i periudhës së parë të përkohshme, Bosnja dhe Hercegovina:

i) Do të ketë zbatuar të gjithë legjislacionin mbi hekurudhat, siç përcaktohet në aneksin I;

ii) Do të ketë bërë progres të mjaftueshëm në zbatimin e rregullave mbi ndihmën shtetërore dhe konkurrencën që përfshihet në një marrëveshje të referuar në nenin 17 të Traktatit Kryesor ose në aneksin III, cilado që të jetë e zbatueshme.

2. Nga fundi i periudhës së dytë të përkohshme, Bosnja dhe Hercegovina do të zbatojë këtë Traktat, duke përfshirë të gjithë legjislacionin mbi hekurudhat dhe rregullat për ndihmën shtetërore dhe konkurrencën e referuar në paragrafin 1.



Neni 3

1. Pavarësisht nenit 1(1) të Traktatit Kryesor:

i) Gjatë periudhës së parë të përkohshme, sipërmarrjeve hekurudhore të licencuara në Bosnjë dhe Hercegovinë do t'u jepet akses në infrastrukturën hekurudhore në Bosnjë dhe Hercegovinë;

ii) Gjatë periudhës së dytë të përkohshme, sipërmarrjet hekurudhore të licencuara në Bosnjë dhe Hercegovinë do të lejohen të ushtrojnë të drejtat e trafikut që jepen në legjislacionin hekurudhor të referuar në aneksin I mbi infrastrukturën hekurudhore të çdo Pale tjetër të Evropës Juglindore.

II. Kushtet lidhur me tranzicionin për transportin detar

Neni 1

1. Periudha e parë e përkohshme do të shtrihet nga hyrja në fuqi e këtij Traktati derisa të jenë përmbushur nga Bosnja dhe Hercegovina të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 2(1) të këtij Protokollit, të verifikuara nga një vlerësim i kryer nga Komisioni Evropian, në përputhje me procedurat e referuara në nenin 40 të Traktatit Kryesor.

2. Periudha e dytë e përkohshme do të shtrihet nga fundi i periudhës së parë të përkohshme derisa të jenë përmbushur nga Bosnja dhe Hercegovina të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 2(2) të këtij Protokollit, të verifikuara nga një vlerësim i kryer nga Komisioni Evropian në përputhje me procedurat e referuara në nenin 40 të Traktatit Kryesor.

Neni 2

1. Nga fundi i periudhës së parë të përkohshme, Bosnja dhe Hercegovina:

i) Do të ketë zbatuar të gjithë legjislacionin mbi legjislacion detar, siç përcaktohet në aneksin I, me përjashtim të Rregullores (KEE) nr. 3577/92;

ii) Qytetarët e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe shoqëritë e transportit detar të ngritura në Bosnjë dhe Hercegovinë do të gëzojnë të drejtën të transportojnë pasagjerë ose mallra me mjete detare ndërmjet çdo porti të një Shteti Anëtar dhe çdo porti të një Shteti tjetër Anëtar ose të një vendi që nuk është Anëtar i Bashkimit

Evropian. Kjo do të zbatohet për qytetarët dhe shoqëritë e transportit detar të Bosnjës dhe Hercegovinës të ngritura jashtë Bosnjës dhe Hercegovinës dhe që kontrollohen nga qytetarë të Bosnjës dhe Hercegovinës, nëse mjetet e tyre detare janë të regjistruara në Bosnjë dhe Hercegovinë në përputhje me legjislacionin e saj.

Në mënyrë reciproke, pronarë anijesh në BE do të gëzojnë të drejtën të transportojnë pasagjerë ose mallra me mjete detare ndërmjet çdo porti ose instalimi larg bregut të një Shteti Anëtar të BE-së dhe të Bosnjës dhe të Hercegovinës dhe çdo porti ose instalim larg bregut të një vendi që nuk është anëtar i Bashkimit Evropian dhe Bosnjës dhe Hercegovinës. Kjo do të zbatohet për qytetarët e Shteteve Anëtare të BE-së dhe shoqëritë e transportit detar të BE-së të ngritura jashtë Bashkimit Evropian dhe që kontrollohen nga qytetarë të Shteteve Anëtare të BE-së, nëse mjetet e tyre detare janë të regjistruara në Shtetet Anëtare të BE-së, në përputhje me legjislacionin e tyre.

2. Nga fundi i periudhës së dytë të përkohshme:

i) Bosnja dhe Hercegovina do të zbatojë këtë Traktat, duke përfshirë të gjithë legjislacionin e përcaktuar në aneksin I;

ii) Pronarë anijesh të BE-së që drejtojnë anije të regjistruara në një Shtet Anëtar të BE-së ose në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe që mbajnë flamurin e atij Shteti Anëtar apo të Bosnjës dhe të Hercegovinës, do të kenë lirinë që të ofrojnë shërbime transporti brenda Bosnjës dhe Hercegovinës dhe nën kushtet e përcaktuara në Rregulloren (KEE) nr. 3577/92.

Në mënyrë reciproke, pronarë anijesh të Bosnjës dhe Hercegovinës që drejtojnë anije të regjistruara në një Shtet Anëtar të BE-së ose në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe që mbajnë flamurin e atij Shteti Anëtar apo të Bosnjës dhe të Hercegovinës do të kenë lirinë që të ofrojnë shërbime transporti brenda çdo Shteti Anëtar të BE-së, nën kushtet e përcaktuara në Rregulloren (KEE) nr. 3577/92.



III. Kushtet në lidhje me tranzicionin për transportin në rrugët ujore tokësore

Neni 1

1. Periudha e parë e përkohshme do të shtrihet nga hyrja në fuqi e këtij Traktati derisa të jenë përmbushur nga Bosnja dhe Hercegovina të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 2 të këtij Protokoll, të verifikuara nga një vlerësim i kryer nga Komisioni Evropian, në përputhje me procedurat e referuara në nenin 40 të Traktatit Kryesor.

Neni 2

1. Nga fundi i periudhës së përkohshme:

i) Bosnja dhe Hercegovina do të zbatojë këtë Traktat, duke përfshirë të gjithë legjislacionin e përcaktuar në aneksin I;

ii) Bosnja dhe Hercegovina do të gëzojë të drejtën të transportojë pasagjerë ose mallra nëpërmjet rrugëve ujore tokësore ndërmjet çdo porti të një Shteti Anëtar dhe çdo porti apo instalimi larg bregut të një Shteti Anëtar tjetër.

PROTOKOLLI III

DISPOZITA TË PËRKOHSHME NDËRMJET BASHKIMIT EVROPIAN NGA NJËRA ANË DHE REPUBLIKËS ISH-JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË NGA ANA TJETËR

I. Kushtet lidhur me tranzicionin për transportin hekurudhor

Neni 1

1. Periudha e parë e përkohshme do të shtrihet nga hyrja në fuqi e këtij Traktati derisa të jenë përmbushur nga Republika ish-Jugosllave e Maqedonisë të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 2(1) të këtij Protokoll, të verifikuara nga një vlerësim i kryer nga Komisioni Evropian në përputhje me procedurat e referuara në nenin 40 të Traktatit Kryesor.

2. Periudha e dytë e përkohshme do të shtrihet nga fundi i periudhës së parë të përkohshme, derisa të jenë përmbushur nga Republika ish-Jugosllave e Maqedonisë të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 2(2) të këtij Protokoll, të verifikuara nga një vlerësim i kryer nga Komisioni Evropian, në përputhje me procedurat e referuara në nenin 40 të Traktatit Kryesor.

3. Republika ish-Jugosllave e Maqedonisë mund t'i kërkojë Komisionit Evropian në fund të

periudhës së parë të përkohshme që të vlerësojë progresin në përputhje me nenin 40 të Traktatit Kryesor, me synimin që të kalojë drejtpërdrejt tek integrimi i tregut sipas nenit 11 të Traktatit Kryesor.

Neni 2

1. Nga fundi i periudhës së parë të përkohshme, Republika ish-Jugosllave e Maqedonisë:

i) Do të ketë zbatuar të gjithë legjislacionin mbi hekurudhat, siç përcaktohet në aneksin I;

ii) Do të ketë bërë progres të mjaftueshëm në zbatimin e rregullave mbi ndihmën shtetërore dhe konkurrencën që përfshihet në një marrëveshje të referuar në nenin 17 të Traktatit Kryesor ose në aneksin III, cilado që të jetë e zbatueshme.

2. Nga fundi i periudhës së dytë të përkohshme, Republika ish-Jugosllave e Maqedonisë do të zbatojë këtë Traktat, duke përfshirë të gjithë legjislacionin mbi hekurudhat dhe rregullat për ndihmën shtetërore dhe konkurrencën, e referuar në paragrafin 1.

Neni 3

1. Pavarësisht nenit 1(1) të Traktatit Kryesor:

i) Gjatë periudhës së parë të përkohshme, sipërmarrjeve hekurudhore të licencuara në Republikën ish-Jugosllave e Maqedonisë do t'u jepet akses në infrastrukturën hekurudhore në Republikën ish-Jugosllave e Maqedonisë;

ii) Gjatë periudhës së dytë të përkohshme, sipërmarrjet hekurudhore të licencuara në Republikën ish-Jugosllave të Maqedonisë do të lejohen të ushtrojnë të drejtat e trafikut që jepen në legjislacionin hekurudhor të referuar në aneksin I mbi infrastrukturën hekurudhore të çdo Pale tjetër të Evropës Juglindore.

II. Kushtet lidhur me tranzicionin për transportin detar

Neni 1

1. Periudha e parë e përkohshme do të shtrihet nga hyrja në fuqi e këtij Traktati derisa të jenë përmbushur nga Republika ish-Jugosllave e Maqedonisë të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 2(1) të këtij Protokoll, të verifikuara nga një vlerësim i kryer nga Komisioni Evropian në përputhje me procedurat e referuara në nenin 40 të Traktatit Kryesor.



2. Periudha e dytë e përkohshme do të shtrihet nga fundi i periudhës së parë të përkohshme derisa të jenë përmbushur nga Republika ish-Jugosllave e Maqedonisë të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 2(2) të këtij Protokoll, të verifikuara nga një vlerësim i kryer nga Komisioni Evropian, në përputhje me procedurat e referuara në nenin 40 të Traktatit Kryesor.

Neni 2

1. 1. Nga fundi i periudhës së parë të përkohshme, Republika ish-Jugosllave e Maqedonisë:

i) Do të ketë zbatuar të gjithë legjislacionin mbi legjislacion detar, siç përcaktohet në aneksin I, me përjashtim të Rregullores (KEE) nr. 3577/92;

ii) Qytetarët e Republikës ish-Jugosllave e Maqedonisë dhe shoqëritë e transportit detar të ngritura në Republikën ish-Jugosllave e Maqedonisë do të gëzojnë të drejtën të transportojnë pasagjerë ose mallra me mjete detare ndërmjet çdo porti të një Shteti Anëtar dhe çdo porti të një Shteti tjetër Anëtar ose të një vendi që nuk është Anëtar i Bashkimit Evropian. Kjo do të zbatohet për qytetarët dhe shoqëritë e transportit detar të Republikës ish-Jugosllave e Maqedonisë të ngritura jashtë Republikës ish-Jugosllave e Maqedonisë dhe që kontrollohen nga qytetarë të Republikës ish-Jugosllave të Maqedonisë, nëse mjetet e tyre detare janë të regjistruara në Republikën ish-Jugosllave e Maqedonisë, në përputhje me legjislacionin e saj.

Në mënyrë reciproke, pronarë anijesh në BE do të gëzojnë të drejtën të transportojnë pasagjerë ose mallra me mjete detare ndërmjet çdo porti ose instalim larg bregut të një Shteti Anëtar të BE-së dhe të Republikës ish-Jugosllave e Maqedonisë, dhe çdo porti ose instalimi larg bregut të një vendi që nuk është Anëtar i Bashkimit Evropian dhe Republikës ish-Jugosllave e Maqedonisë. Kjo do të zbatohet për qytetarët e Shteteve Anëtare të BE-së dhe shoqëritë e transportit detar të BE-së të ngritura jashtë Bashkimit Evropian dhe që kontrollohen nga qytetarë të Shteteve Anëtare të BE-së, nëse mjetet e tyre detare janë të regjistruara në Shtetet Anëtare të BE-së, në përputhje me legjislacionin e tyre.

2. Nga fundi i periudhës së dytë të përkohshme:

i) Republika ish-Jugosllave e Maqedonisë do të aplikojë këtë Traktat duke përfshirë gjithë legjislacionin e përcaktuar në aneksin I;

ii) Pronarë anijesh të BE-së që drejtojnë anije të regjistruara në një Shtet Anëtar të BE-së ose në Republikën ish-Jugosllave e Maqedonisë dhe që mbajnë flamurin e atij Shteti Anëtar apo të Republikës ish-Jugosllave e Maqedonisë, do të kenë lirinë që të ofrojnë shërbime transporti brenda Republikës ish-Jugosllave e Maqedonisë dhe nën kushtet e përcaktuara në Rregulloren nr. 3577/92.

Në mënyrë reciproke, pronarë anijesh të Republikës ish-Jugosllave e Maqedonisë që drejtojnë anije të regjistruara në një Shtet Anëtar të BE-së ose në Republikën ish-Jugosllave e Maqedonisë dhe që mbajnë flamurin e atij Shteti Anëtar apo të Republikës ish-Jugosllave e Maqedonisë do të kenë lirinë që të ofrojnë shërbime transporti brenda çdo Shteti Anëtar të BE-së, nën kushtet e përcaktuara në Rregulloren (KEE) nr. 3577/92.

III. Kushtet lidhur me tranzicionin për transportin në rrugët ujore tokësore

Neni 1

1. Periudha e parë e përkohshme do të shtrihet nga hyrja në fuqi e këtij Traktati derisa të jenë përmbushur nga Republika ish-Jugosllave e Maqedonisë të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 2 të këtij Protokoll, të verifikuara nga një vlerësim i kryer nga Komisioni Evropian, në përputhje me procedurat e referuara në nenin 40 të Traktatit Kryesor.

Neni 2

1. Nga fundi i periudhës së përkohshme:

i) Republika ish-Jugosllave e Maqedonisë do të zbatojë këtë Traktat, duke përfshirë të gjithë legjislacionin e përcaktuar në aneksin I;

ii) Republika ish-Jugosllave e Maqedonisë do të gëzojë të drejtën të transportojë pasagjerë ose mallra nëpërmjet rrugëve ujore tokësore ndërmjet çdo porti të një Shteti Anëtar dhe çdo porti apo instalimi larg bregut të një Shteti Anëtar tjetër.



PROTOKOLLI IV
DISPOZITA TË PËRKOHSHME
NDËRMJETBASHKIMIT EVROPIAN NGA
NJËRA ANË DHE KOSOVËS*
NGA ANA TJETËR

**I. Kushtet lidhur me tranzicionin për
transportin hekurudhor**

Neni 1

1. Periudha e parë e përkohshme do të shtrihet nga hyrja në fuqi e këtij Traktati derisa të jenë përmbushur nga Kosova të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 2(1) të këtij Protokoll, të verifikuara nga një vlerësim i kryer nga Komisioni Evropian, në përputhje me procedurat referuar në nenin 40 të Traktatit Kryesor.

2. Periudha e dytë e përkohshme do të shtrihet nga fundi i periudhës së parë të përkohshme derisa të jenë përmbushur nga Kosova të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 2(2) të këtij Protokoll, të verifikuara nga një vlerësim i kryer nga Komisioni Evropian, në përputhje me procedurat referuar në nenin 40 të Traktatit Kryesor.

3. Kosova mund t'i kërkojë Komisionit Evropian në fund të periudhës së parë të përkohshme që të vlerësojë progresin në përputhje me nenin 40 të Traktatit kryesor, me synimin që të kalojë drejtpërdrejt tek integrimi i tregut sipas nenit 11 të Traktatit Kryesor.

Neni 2

1. Nga fundi i periudhës së parë të përkohshme, Kosova:

i) Do të ketë zbatuar të gjithë legjislacionin mbi hekurudhat siç përcaktohet në aneksin I;

ii) Do të ketë bërë progres të mjaftueshëm në zbatimin e rregullave mbi ndihmën shtetërore dhe konkurrencën që përfshihet në një marrëveshje referuar në nenin 17 të Traktatit Kryesor ose në aneksin III, cilado që të jetë e zbatueshme.

2. Nga fundi i periudhës së dytë të përkohshme, Kosova do të zbatojë këtë Traktat, duke përfshirë

të gjithë legjislacionin mbi hekurudhat dhe rregullat për ndihmën shtetërore dhe konkurrencën e referuar në paragrafin 1.

Neni 3

1. Pavarësisht nenit 1(1) të Traktatit Kryesor:

i) Gjatë periudhës së parë të përkohshme, sipërmarrjeve hekurudhore të licencuara në Kosovë do t'u jepet akses në infrastrukturën hekurudhore në Kosovë;

ii) Gjatë periudhës së dytë të përkohshme, sipërmarrjet hekurudhore të licencuara në Kosovë do të lejohen të ushtrojnë të drejtat e trafikut që jepen në legjislacionin hekurudhor të përmendur në aneksin I mbi infrastrukturën hekurudhore të çdo Pale tjetër të Evropës Juglindore.

II. Kushtet lidhur me transportin rrugor

Bashkimi Evropian dhe Kosova bien dakord që pavarësisht nenit 61(1) të Marrëveshjes së Asociim Stabilizimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, nga njëra anë dhe Kosovës, nga ana tjetër, kapitulli III në këtë Marrëveshje mbi trafikun transit, do të vijojë të zbatohet sapo të hyjë në fuqi Traktati që krijon Komunitetin e Transportit.

**III. Kushtet lidhur me tranzicionin për
transportin detar**

Neni 1

1. Periudha e parë e përkohshme do të shtrihet nga hyrja në fuqi e këtij Traktati derisa të jenë përmbushur nga Kosova të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 2(1) të këtij Protokoll, të verifikuara nga një vlerësim i kryer nga Komisioni Evropian në përputhje me procedurat e përmendura në nenin 40 të Traktatit Kryesor.

2. Periudha e dytë e përkohshme do të shtrihet nga fundi i periudhës së parë të përkohshme derisa të jenë përmbushur nga Kosova të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 2(2) të këtij Protokoll, të verifikuara nga një vlerësim i kryer nga Komisioni Evropian, në përputhje me procedurat e përmendura në nenin 40 të Traktatit Kryesor.

* Ky përcaktim nuk cenon pozicionet mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën UNSCR 1244/1999 dhe Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mbi deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.



Neni 2

1. Nga fundi i periudhës së parë të përkohshme:

i) Kosova do të ketë zbatuar të gjithë legjislacionin mbi legjislacion detar siç përcaktohet në aneksin I, me përjashtim të Rregullores (KEE) nr. 3577/92;

ii) Qytetarët e Kosovës dhe shoqëritë e transportit detar të ngritura në Kosovë do të gëzojnë të drejtën të transportojnë pasagjerë ose mallra me mjete detare ndërmjet çdo porti të një Shteti Anëtar dhe çdo porti të një Shteti tjetër Anëtar ose të një vendi që nuk është Anëtar i Bashkimit Evropian. Kjo zbatohet edhe për qytetarët dhe shoqëritë e transportit detar të Kosovës të ngritura jashtë Kosovës dhe që kontrollohen nga qytetarë të Kosovës, nëse mjetet e tyre detare janë të regjistruara në Kosovë, në përputhje me legjislacionin e saj.

Në mënyrë reciproke, pronarë anijesh në BE do të gëzojnë të drejtën të transportojnë pasagjerë ose mallra me mjete detare ndërmjet çdo porti ose instalim larg bregut të një Shteti Anëtar të BE-së dhe të Kosovës dhe çdo porti ose instalimi larg bregut të një vendi që nuk është anëtar i Bashkimit Evropian dhe Kosovës. Kjo do të zbatohet për qytetarët e Shteteve Anëtare të BE-së dhe shoqëritë e transportit detar të BE-së të themeluara jashtë Bashkimit Evropian dhe që kontrollohen nga qytetarë të Shteteve Anëtare të BE-së, nëse mjetet e tyre detare janë të regjistruara në Shtetet Anëtare të BE-së, në përputhje me legjislacionin e tyre.

2. Nga fundi i periudhës së dytë të përkohshme:

i) Kosova do të zbatojë këtë Traktat, duke përfshirë të gjithë legjislacionin e përcaktuar në aneksin I;

ii) Pronarë anijesh të BE-së që drejtojnë anije të regjistruara në një Shtet Anëtar të BE-së ose në Kosovë dhe që mbajnë flamurin e atij Shteti Anëtar apo të Kosovës, do të kenë lirinë që të ofrojnë shërbime transporti brenda Kosovës dhe nën kushtet e përcaktuara në Rregulloren nr. 3577/92.

Në mënyrë reciproke, pronarë anijesh të Kosovës që drejtojnë anije të regjistruara në një Shtet Anëtar të BE-së ose në Kosovën dhe që mbajnë flamurin e atij Shteti Anëtar apo të

Kosovës do të kenë lirinë që të ofrojnë shërbime transporti brenda çdo Shteti Anëtar të BE-së, nën kushtet e përcaktuara në Rregulloren (KEE) Nr. 3577/92.

IV. Kushtet në lidhje me tranzicionin për transportin në rrugët ujore tokësore

Neni 1

1. Periudha e parë e përkohshme do të shtrihet nga hyrja në fuqi e këtij Traktati derisa të jenë përmbushur të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 2 të këtij Protokollit nga Kosova, të verifikuara nga një vlerësim i kryer nga Komisioni Evropian, në përputhje me procedurat e përmendura në nenin 40 të Traktatit Kryesor.

Neni 2

Nga fundi i periudhës së përkohshme:

i) Kosova do të zbatojë këtë Traktat, duke përfshirë të gjithë legjislacionin e përcaktuar në aneksin I;

ii) Kosova do të gëzojë të drejtën të transportojë pasagjerë ose mallra nëpërmjet rrugëve ujore tokësore ndërmjet çdo porti të një Shteti Anëtar dhe çdo porti apo instalimi larg bregut të një Shteti Anëtar tjetër.

PROTOKOLLI V DISPOZITA TË PËRKOHSHME NDËRMJET BASHKIMIT EVROPIAN, NGA NJËRA ANË DHE MALIT TË ZI, NGA ANA TJETËR

I. Kushtet lidhur me tranzicionin për transportin hekurudhor

Neni 1

1. Periudha e parë e përkohshme do të shtrihet nga hyrja në fuqi e këtij Traktati derisa të jenë përmbushur nga Mali i Zi të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 2(1) të këtij Protokollit, të verifikuara nga një vlerësim i kryer nga Komisioni Evropian, në përputhje me procedurat e referuara në nenin 40 të Traktatit Kryesor.

2. Periudha e dytë e përkohshme do të shtrihet nga fundi i periudhës së parë të përkohshme derisa të jenë përmbushur nga Mali i Zi të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 2(2) të këtij Protokollit, të verifikuara nga një vlerësim i



kryer nga Komisioni Evropian, në përputhje me procedurat e referuara në nenin 40 të Traktatit Kryesor.

3. Mali i Zi mund t'i kërkojë Komisionit Evropian në fund të periudhës së parë të përkohshme që të vlerësojë progresin në përputhje me nenin 40 të Traktatit Kryesor, me synimin që të kalojë drejtpërdrejt tek integrimi i tregut sipas nenit 11 të Traktatit Kryesor.

Neni 2

1. Nga fundi i periudhës së parë të përkohshme, Mali i Zi:

i) Do të ketë zbatuar të gjithë legjislacionin mbi hekurudhat, siç përcaktohet në aneksin I;

ii) Do të ketë bërë progres të mjaftueshëm në zbatimin e rregullave mbi ndihmën shtetërore dhe konkurrencën që përfshihet në një marrëveshje të referuar në nenin 17 të Traktatit Kryesor ose në aneksin III, cilado që të jetë e zbatueshme.

2. Nga fundi i periudhës së dytë të përkohshme, Mali i Zi do të zbatojë këtë Traktat, duke përfshirë të gjithë legjislacionin mbi hekurudhat dhe rregullat mbi ndihmën shtetërore dhe konkurrencën e referuar në paragrafin 1.

Neni 3

1. Pavarësisht nenit 1(1) të Traktatit Kryesor:

i) Gjatë periudhës së parë të përkohshme, sipërmarrjeve hekurudhore të licencuara në Malin e Zi do t'u jepet akses në infrastrukturën hekurudhore në Malin e Zi;

ii) Gjatë periudhës së dytë të përkohshme, sipërmarrjet hekurudhore të licencuara në Malin e Zi do të lejohen të ushtrjnë të drejtat e trafikut që jepen në legjislacionin hekurudhor të referuar në aneksin I mbi infrastrukturën hekurudhore të çdo Pale tjetër të Evropës Juglindore.

II. Kushtet lidhur me tranzicionin për transportin detar

Neni 1

1. Periudha e parë e përkohshme do të shtrihet nga hyrja në fuqi e këtij Traktati derisa të jenë përmbushur nga Mali i Zi të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 2(1) të këtij Protokoll, të verifikuara nga një vlerësim i kryer nga Komisioni Evropian, në përputhje me

procedurat e referuara në nenin 40 të Traktatit Kryesor.

2. Periudha e dytë e përkohshme do të shtrihet nga fundi i periudhës së parë të përkohshme derisa të jenë përmbushur nga Mali i Zi të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 2(2) të këtij Protokoll, të verifikuara nga një vlerësim i kryer nga Komisioni Evropian, në përputhje me procedurat e referuara në nenin 40 të Traktatit Kryesor.

Neni 2

1. Nga fundi i periudhës së parë të përkohshme:

i) Mali i Zi do të ketë zbatuar të gjithë legjislacionin mbi legjislacionin detar siç përcaktohet në aneksin I me përjashtim të Rregullores (KEE) nr. 3577/92;

ii) Qytetarët e Malit të Zi dhe shoqëritë e transportit detar të ngritura në Malin e Zi do të gëzojnë të drejtën të transportojnë pasagjerë ose mallra me mjete detare ndërmjet çdo porti të një Shteti Anëtar dhe çdo porti të një Shteti tjetër Anëtar ose të një vendi që nuk është Anëtar i Bashkimit Evropian. Kjo do të zbatohet për qytetarët dhe shoqëritë e transportit detar të Malit të Zi të ngritura jashtë Malit të Zi dhe që kontrollohen nga qytetarë të Malit të Zi, nëse mjetet e tyre detare janë të regjistruara në Malin e Zi, në përputhje me legjislacionin e saj.

Në mënyrë reciproke, pronarë anijesh në BE do të gëzojnë të drejtën të transportojnë pasagjerë ose mallra me mjete detare ndërmjet çdo porti ose instalim larg bregut të një Shteti Anëtar të BE-së dhe të Malit të Zi, dhe çdo porti ose instalim larg bregut të një vendi që nuk është Anëtar i Bashkimit Evropian dhe Malit të Zi. Kjo do të zbatohet për qytetarët e Shteteve Anëtare të BE-së dhe shoqëritë e transportit detar të BE-së të ngritura jashtë Bashkimit Evropian dhe që kontrollohen nga qytetarë të Shteteve Anëtare të BE-së, nëse mjetet e tyre detare janë të regjistruara në Shtetet Anëtare të BE-së në përputhje me legjislacionin e tyre.

2. Nga fundi i periudhës së dytë të përkohshme:

i) Mali i Zi do të zbatojë këtë Traktat, duke përfshirë të gjithë legjislacionin e përcaktuar në aneksin I;



ii) Pronarë anijesh të BE-së që drejtojnë anije të regjistruara në një Shtet Anëtar të BE-së ose në Malin e Zi dhe që mbajnë flamurin e atij Shteti Anëtar apo të Malit të Zi, do të kenë lirinë që të ofrojnë shërbime transporti brenda Malit të Zi dhe nën kushtet e përcaktuara në Rregulloren (KEE) nr. 3577/92.

Në mënyrë reciproke, pronarë anijesh të Malit të Zi që drejtojnë anije të regjistruara në një Shtet Anëtar të BE-së ose në Malin e Zi dhe që mbajnë flamurin e atij Shteti Anëtar apo të Malit të Zi do të kenë lirinë që të ofrojnë shërbime transporti brenda çdo Shteti Anëtar të BE-së nën kushtet e përcaktuara në Rregulloren nr. 3577/92.

III. Kushtet lidhur me tranzicionin për transportin në rrugët ujore tokësore

Neni 1

1. Periudha e parë e përkohshme do të shtrihet nga hyrja në fuqi e këtij Traktati derisa të jenë përmbytur të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 2 të këtij Protokoll nga Mali i Zi, të verifikuara nga një vlerësim i kryer nga Komisioni Evropian në përputhje me procedurat e referuara në nenin 40 të Traktatit Kryesor.

Neni 2

Nga fundi i periudhës së përkohshme:

i) Mali i Zi do të zbatojë këtë Traktat, duke përfshirë të gjithë legjislacionin e përcaktuar në aneksin I;

ii) Mali i Zi do të gëzojë të drejtën të transportojë pasagjerë ose mallra nëpërmjet rrugëve ujore tokësore ndërmjet çdo porti të një Shteti Anëtar dhe çdo porti apo instalimi larg bregut të një Shteti Anëtar tjetër.

PROTOKOLLI VI

DISPOZITA TË PËRKOHSHME NDËRMJET BASHKIMIT EVROPIAN, NGA NJËRA ANË DHE REPUBLIKËS SË SERBISË, NGA ANA TJETËR

I. Kushtet lidhur me tranzicionin për transportin hekurudhor

Neni 1

1. Periudha e parë e përkohshme do të shtrihet nga hyrja në fuqi e këtij Traktati derisa të jenë përmbytur nga Republika e Serbisë të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 2(1) të këtij

Protokoll, që në vijim në këtë dokument do të referohet si “Serbia”, të verifikuara nga një vlerësim i kryer nga Komisioni Evropian, në përputhje me procedurat e referuara në nenin 40 të Traktatit Kryesor.

2. Periudha e dytë e përkohshme do të shtrihet nga fundi i periudhës së parë të përkohshme derisa të jenë përmbytur nga Serbia të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 2(2) të këtij Protokoll, të verifikuara nga një vlerësim i kryer nga Komisioni Evropian, në përputhje me procedurat e referuara në nenin 40 të Traktatit Kryesor.

3. Serbia mund t’i kërkojë Komisionit Evropian në fund të periudhës së parë të përkohshme që të vlerësojë progresin, në përputhje me nenin 40 të Traktatit Kryesor, me synimin që të kalojë drejtpërdrejt tek integrimi i tregut sipas nenit 11 të Traktatit Kryesor.

Neni 2

1. Nga fundi i periudhës së parë të përkohshme, Serbia:

i) Do të ketë zbatuar të gjithë legjislacionin mbi hekurudhat siç përcaktohet në aneksin I;

ii) Do të ketë bërë progres të mjaftueshëm në zbatimin e rregullave mbi ndihmën shtetërore dhe konkurrencën që përfshihet në një marrëveshje e referuar në nenin 17 të Traktatit Kryesor ose në aneksin III, cilado që të jetë e zbatueshme.

2. Nga fundi i periudhës së dytë të përkohshme, Serbia do të zbatojë këtë Traktat, duke përfshirë të gjithë legjislacionin mbi hekurudhat dhe rregullat mbi ndihmën shtetërore dhe konkurrencën e referuar në paragrafin 1.

Neni 3

1. Pavarësisht nenit 1(1) të Traktatit Kryesor:

i) Gjatë periudhës së parë të përkohshme sipërmarrjeve hekurudhore të licencuara në Serbi, do t’u jepet akses në infrastrukturën hekurudhore në Serbinë;

ii) Gjatë periudhës së dytë të përkohshme sipërmarrjet hekurudhore të licencuara në Serbi do të lejohen të ushtrojnë të drejtat e trafikut që jepen në legjislacionin hekurudhor të referuara në aneksin I mbi infrastrukturën hekurudhore të çdo Pale tjetër të Evropës Juglindore.



II. Kushtet lidhur me tranzicionin për transportin detar

Neni 1

1. Periudha e parë e përkohshme do të shtrihet nga hyrja në fuqi e këtij Traktati derisa të jenë përmbushur nga Serbia të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 2(1) të këtij Protokoll, të verifikuara nga një vlerësim i kryer nga Komisioni Evropian, në përputhje me procedurat e referuara në nenin 40 të Traktatit Kryesor.

2. Periudha e dytë e përkohshme do të shtrihet nga fundi i periudhës së parë të përkohshme derisa të jenë përmbushur nga Serbia të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 2(2) të këtij Protokoll, të verifikuara nga një vlerësim i kryer nga Komisioni Evropian, në përputhje me procedurat e referuara në nenin 40 të Traktatit Kryesor.

Neni 2

1. Nga fundi i periudhës së parë të përkohshme, Serbia:

i) Do të ketë zbatuar të gjithë legjislacionin mbi legjislacion detar, siç përcaktohet në aneksin I, me përjashtim të Rregullores (KEE) nr. 3577/92;

ii) Qytetarët e Serbisë dhe shoqëritë e transportit detar të ngritura në Serbinë do të gëzojnë të drejtën të transportojnë pasagjerë ose mallra me mjete detare ndërmjet çdo porti të një Shteti Anëtar dhe çdo porti të një Shteti tjetër Anëtar ose të një vendi që nuk është Anëtar i Bashkimit Evropian. Kjo do të zbatohet për qytetarët dhe shoqëritë e transportit detar të Serbisë të ngritura jashtë Serbisë dhe që kontrollohen nga qytetarë të Serbisë, nëse mjetet e tyre detare janë të regjistruara në Serbi, në përputhje me legjislacionin e saj.

Në mënyrë reciproke, pronarë anijesh në BE do të gëzojnë të drejtën të transportojnë pasagjerë ose mallra me mjete detare ndërmjet çdo porti ose instalim larg bregut të një Shteti Anëtar të BE-së dhe të Serbisë, dhe çdo porti ose instalim larg bregut të një vendi që nuk është Anëtar i Bashkimit Evropian dhe Serbisë. Kjo do të zbatohet për qytetarët e Shteteve Anëtare të BE-së dhe shoqëritë e transportit detar të BE-së

të ngritura jashtë Bashkimit Evropian dhe që kontrollohen nga qytetarë të Shteteve Anëtare të BE-së, nëse mjetet e tyre detare janë të regjistruara në Shtetet Anëtare të BE-së, në përputhje me legjislacionin e tyre.

2. Nga fundi i periudhës së dytë të përkohshme:

i) Serbia do të zbatojë këtë Traktat, duke përfshirë të gjithë legjislacionin e përcaktuar në aneksin I.

ii) Pronarë anijesh të BE-së që drejtojnë anije të regjistruara në një Shtet Anëtar të BE-së ose në Serbinë dhe që mbajnë flamurin e atij Shteti Anëtar apo të Serbisë, do të kenë lirinë që të ofrojnë shërbime transporti brenda Serbisë dhe nën kushtet e përcaktuara në Rregulloren (KEE) nr. 3577/92.

Në mënyrë reciproke, pronarë anijesh të Serbisë që drejtojnë anije të regjistruara në një Shtet Anëtar të BE-së ose në Serbi dhe që mbajnë flamurin e atij Shteti Anëtar apo të Serbisë do të kenë lirinë që të ofrojnë shërbime transporti brenda çdo Shteti Anëtar të BE-së nën kushtet e përcaktuara në Rregulloren nr. 3577/92.

III. Kushtet lidhur me tranzicionin për transportin në rrugët ujore tokësore

Neni 1

1. Periudha e parë e përkohshme do të shtrihet nga hyrja në fuqi e këtij Traktati derisa të jenë përmbushur nga Serbia të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 2 të këtij Protokoll, të verifikuara nga një vlerësim i kryer nga Komisioni Evropian, në përputhje me procedurat e referuara në nenin 40 të Traktatit Kryesor.

Neni 2

Nga fundi i periudhës së përkohshme:

i) Serbia do të zbatojë këtë Traktat, duke përfshirë të gjithë legjislacionin e përcaktuar në aneksin I.

ii) Serbia do të gëzojë të drejtën të transportojë pasagjerë ose mallra nëpërmjet rrugëve ujore tokësore ndërmjet çdo porti të një Shteti Anëtar dhe çdo porti apo instalimi larg bregut të një Shteti Anëtar tjetër.



LIGJ
Nr. 9/2018

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.
9875, DATË 14.2.2008, “PËR
METROLOGJINË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Neni 38, i ligjit nr. 9875, datë 14.2.2008, “Për metrologjinë”, të ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 2
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 5.3.2018

Shpallur me dekretin nr. 10739, datë 12.3.2018, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

LIGJ
Nr. 10/2018

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË BOSNJËS DHE
HERCEGOVINËS, QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË,
QEVERISË SË MALIT TË ZI, QEVERISË
SË REPUBLIKËS SË SERBISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
SLLOVENISË PËR NGRITJEN E TASK-
FORCËS MJEKËSORE TË BALLKANIT

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës, Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Qeverisë së Malit të Zi, Qeverisë së Republikës së Serbisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovenisë për ngritjen e Task-Forcës Mjekësore të Ballkanit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 5.3.2018

Shpallur me dekretin nr. 10740, datë 12.3.2018, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË BOSNJËS
DHE HERCEGOVINËS, QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË,
QEVERISË SË MALIT TË ZI, QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË SERBISË DHE QEVERISË
SË REPUBLIKËS SË SLLOVENISË, MBI
NGRITJEN E TASK-FORCËS MJEKËSORE
TË BALLKANIT

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Ministrave i Bosnjës dhe Hercegovinës, Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Qeveria e Malit të Zi, Qeveria e Republikës së Serbisë dhe Qeveria e Republikës së Sllovenisë, më poshtë të referuara si “Palët”, duke identifikuar kapacitetet rajonale operacionale mjekësore dhe duke njohur nevojën për përdorim të përmirësuar të kapaciteteve mjekësore ushtarake ekzistuese në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe duke vërejtur se duke qenë pjesë e një iniciative bashkëpunimi shumëkombëshe, shteteve u jepet mundësia të përdorin asetet e tyre mjekësore me më shumë



efikasitet, pa mbivendosje dhe pa humbur efektivitetin;

duke iu referuar qëllimit të zhvillimit të një koncepti që është miratuar nga nënshkrimi i Deklaratës së Qëllimit të Grupit të Vlerësimit të Task-Forcës Mjekësore të Ballkanit, të datës ... 2014,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Përkufizime

1. “Task-Forca Mjekësore e Ballkanit (BMTF)”, Njësia Ushtarake Mjekësore Shumëkombëshe e përbërë nga modulet mjekësore, të formuara nga kontributet e Palëve.

2. “Shtet Kuadër (FN)”, një palë që ofron, mbi bazë rotacioni, infrastrukturën, personelin dhe pajisjet bazë të nevojshme për kapacitetin e ROLE 2, përveç detyrimit të saj si Palë, siç përcaktohet në këtë Marrëveshje dhe në marrëveshjet zbatuese.

3. “Sponsor”, çdo shtet, organizatë ose subjekt, i ndryshëm nga pjesëmarrësit në BMTF, që ofron mbështetje financiare dhe/ose mbështetje tjetër për BMTF-në, siç përcaktohet në marrëveshjen përkatëse.

4. “Shtet pritës (HN)”, Republika e Maqedonisë që ofron vendosjen e Strukturës Organizative të Përhershme të BMTF-së.

5. “Organizata e Përhershme e BMTF-së”, organ i përhershëm në kohë paqeje i BMTF-së, përgjegjëse për organizimin dhe planifikimin e aktiviteteve të trajnimit dhe operacioneve në kohë paqeje dhe/ose operacioneve të paparashikuara të BMTF-së.

Neni 2

Qëllimi i Marrëveshjes

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është rregullimi i procedurave dhe përgjegjësisive ndërmjet Palëve për ngritjen dhe funksionimin e BMTF-së.

Neni 3

Misioni i BMTF-së

1. Me qëllim identifikimin, përmirësimin dhe lehtësimin e kapaciteteve operacionale mjekësore të rajonit të Ballkanit Perëndimor, qëllimi i BMTF-së është vënia në dispozicion e mbështetjes mjekësore në nivelin e ROLE 2 në

operacionet në përgjigje të krizave (CRO), në një mënyrë të qëndrueshme dhe për t’u përgjigjur brenda një kohe të shpejtë një spektri të gjerë të situatave të ndihmës në raste të fatkeqësive rajonale. Qëllimi është mundësimi i shteteve pjesëmarrëse që të ofrojnë kapacitete kryesore në operacionet ndërkombëtare, të përmirësojnë kapacitetet e shërbimeve mjekësore kombëtare dhe të arrijnë qëllimet kombëtare të forcës/partneritetit të NATO-s dhe Partneritetit për Paqe (Pfp) (objektivat e kapaciteteve).

2. Me qëllim përbushjen e qëllimeve të lartpërmendura, BMTF-ja do të jetë e aftë:

a) Të planifikojë, të zhvillojë dhe të marrë pjesë në aktivitetet shumëkombëshe të trajnimit, që synojnë arritjen dhe ruajtjen e gatishmërisë, kapaciteteve dhe efektivitetit të duhur operacional, si dhe të kontribuojë në përmirësimin e ndërveprueshmërisë;

b) Të marrë pjesë në misionet e mandatuara nga OKB-ja brenda fushës së miratuar të përgjegjësisë;

c) Të zhvillojë aktivitete të tjera të rena dakord bashkërisht nga Palët.

Neni 4

Aktivizimi i BMTF-së

1. BMTF-ja vihet në dispozicion për aktivizim të mundshëm:

a) Me kërkesë të një ose më shumë palëve; ose

b) Me kërkesë të organizatës ndërkombëtare përkatëse; ose

c) Me kërkesë të një shteti tjetër.

2. Me pëlqimin paraprak të autoriteteve kombëtare të secilës Palë, aktivizimi i BMTF-së i nënshtrohet vendimmarrjes së SB-së.

Neni 5

Struktura, marrëdhëniet e komandimit dhe vendimmarrja në BMTF

1. BMTF-ja do të funksionojë në kohë paqeje dhe në kriza, siç përcaktohet hollësisht në këtë nen.

2. BMTF-ja do të jetë një njësi mjekësore shumëkombëshe, si një kapacitet ushtarak modular i dislokueshëm, i krijuar në bazë të kapaciteteve mjekësore kombëtare ekzistuese.

3. Organizata e Përhershme e BMTF-së (BMTF SO) është një organ i përhershëm në kohë paqeje i BMTF-së, përgjegjëse për organizimin dhe planifikimin e aktiviteteve të trajnimit, si dhe



operacioneve në kohë paqeje dhe/ose operacioneve të paparashikuara të BMTF-së. Ajo është gjithashtu përgjegjëse për përgatitjen, trajnimin dhe certifikimin e njësisë.

4. Bordi Drejtues (SB) është organi më i lartë vendimmarrës, që përbëhet nga përfaqësuesit e autorizuar politikë dhe ushtarakë nga secila palë. SB-ja i merr vendimet me unanimitet.

5. Struktura e detajuar dhe marrëdhëniet e komandimit të BMTF-së do të përcaktohen në Memorandumin e Mirëkuptimit ose në dokumente të tjera përkatëse që do të nënshkruhen nga autoritetet përkatëse të Palëve.

6. Struktura organizative e BMTF-së së aktivizuar hyn në fuqi në kohë krize dhe do të përcaktohet në Memorandumin e Mirëkuptimit ose në dokumente të tjera përkatëse që do të nënshkruhen nga autoritetet përkatëse të Palëve.

Neni 6

Gjuhët zyrtare dhe të punës

Gjuhët zyrtare të BMTF-së janë gjuhët kombëtare të Palëve. Gjuha angleze do të jetë gjuha e punës dhe të gjitha dokumentet operacionale duhet të lëshohen në këtë gjuhë.

Neni 7

Aspektet financiare

1. Kostot në lidhje me ngritjen, administrimin dhe funksionimin e BMTF-së financohen nga Palët dhe/ose sponsorët.

2. Shpenzimet e përbashkëta për BMTF SO-në do të mbulohen nga buxheti shumëkombësh i financuar nga Palët, në përputhje me formulën për ndarjen e shpenzimeve, që do të përcaktohet në Memorandumin e Mirëkuptimit.

3. Pajisjet e blera nga fondet e përbashkëta dhe pajisjet e dhëna nga sponsorët do të jenë pronë e BMTF-së. Titulli i pronësisë i pajisjeve kombëtare të dhëna nga HN-ja i mbetet HN-së.

4. Parimet e hollësishme dhe metodat e financimit të BMTF-së do të përcaktohen në Memorandumin e Mirëkuptimit.

Neni 8

Shteti pritës dhe mbështetja e shtetit kuadër

1. HN-ja do të ofrojë mbështetjen logjistike për BMTF SO-në, siç përcaktohet në Memorandumin e Mirëkuptimit.

2. Një prej Palëve, mbi baza rotacioni, merr rolin e Shtetit Kuadër (FN). Si e tillë, përveç detyrimit të saj si Palë, ajo ofron infrastrukturën, personelin dhe pajisjet bazë të nevojshme për kapacitetin e ROLE 2. Detyrimet e hollësishme të një FN-je do të rregullohen në Memorandumin e Mirëkuptimit.

Neni 9

Konsideratat juridike

Dispozitat e “Marrëveshjes ndërmjet Palëve të Traktatit të Atlantikut Verior në lidhje me statusin e forcave të tyre” (NATO SOFA, e datës 19 qershor 1951), Marrëveshjes ndërmjet Shteteve Palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera që marrin pjesë në partneritetin për paqe, në lidhje me statusin e forcave të tyre (PfP SOFA, e datës 19 qershor 1995) dhe Konventës së OKB-së mbi privilegjet dhe imunitetet e Kombeve të Bashkuara (e datës 13 shkurt 1946), rregullojnë statusin e personelit të BMTF-së, sipas rastit.

Neni 10

Pranimi në BMTF dhe pjesëmarrja në aktivitetet e BMTF-së

1. Çdo shtet mund të pranohet në këtë Marrëveshje me marrjen e pëlqimit paraprak me shkrim të të gjitha Palëve dhe nënshkrimin e një note pranimi në këtë Marrëveshje.

2. Çdo organizatë ndërkombëtare, subjekt ose çdo shtet/forcë e shtetit mund të marrë pjesë në aktivitetet e trajtimit ose operacionet e BMTF-së me pëlqimin paraprak të të gjitha Palëve dhe pas nënshkrimit të një marrëveshjeje përkatëse.

Neni 11

Klauzolat e sigurisë

1. I gjithë informacioni i shkëmbyer ose i gjeneruar në lidhje me këtë Marrëveshje përdoret, transmetohet, ruhet, trajtohet dhe/ose sigurohet në përputhje me ligjet dhe rregulloret kombëtare dhe ndërkombëtare të zbatueshme të Palëve.

2. Informacioni transferohet vetëm nëpërmjet kanaleve të lejuara.

3. Palët garantojnë që i gjithë shkëmbimi i informacionit të përdoret vetëm për qëllimet e caktuara brenda objektivave dhe fushës së veprimit të kësaj Marrëveshjeje.



Neni 12

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje zgjidhet vetëm me konsensus të përbashkët ndërmjet Palëve dhe nuk i referohet për zgjidhje asnjë gjykatë kombëtare ose ndërkombëtare ose Pale të Tretë.

Neni 13

Marrëveshjet zbatuese

Çështjet e hollësishme në lidhje me BMTF-në përcaktohen në një memorandum të veçantë mirëkuptimi ose në dokumente të tjera përkatëse të nënshkruara nga autoritetet përkatëse të Palëve.

Neni 14

Dispozita të fundit

1. Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar kohore.

2. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e 30-të pas njoftimit të fundit nga Palët drejtuar HN-së që janë përfunduar të gjitha procedurat e brendshme për hyrjen e saj në fuqi.

3. Kjo Marrëveshje ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të Palëve. Ndryshimi propozohet me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike dhe hyn në fuqi në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni.

4. Kjo Marrëveshje përfundon me pëlqim unanim të Palëve në çdo kohë. Çdo Palë mund të tërhiqet nga Marrëveshja pas një njoftimi me shkrim me afat gjashtëmujor (6-mujor) drejtuar HN-së, i cili njofton Palët e tjera në rrugë diplomatike.

5. Nëse kjo Marrëveshje përfundon ose në qoftë se një prej Palëve tërhiqet nga Marrëveshja, Palët do të zgjidhin të gjitha çështjet e mbetura, si dhe fusha të mundshme të interesit në lidhje me përfundimin ose tërheqjen nga Marrëveshja.

6. Prishja e Marrëveshjes shfuqizon të gjitha marrëveshjet/memorandumet zbatuese të mirëkuptimit.

7. Shteti pritës do të jetë depozitari i kësaj Marrëveshjeje.

Në dëshmi të kësaj, përfaqësuesit e poshtëshënuar, të autorizuar rregullisht nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë marrëveshje.

Nënshkruar në gjashtë (6) kopje origjinale në gjuhën angleze.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë: _____

Nënshkruar në _____, më _____

Për Këshillin e Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës: _____

Nënshkruar në _____, më _____

Për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë:

Nënshkruar në _____, më _____

Për Qeverinë e Malit të Zi:

Nënshkruar në _____, më _____

Për Qeverinë e Republikës së Serbisë:

Nënshkruar në _____, më _____

Për Qeverinë e Republikës së Sllovenisë:

Nënshkruar në _____, më _____

LIGJ**Nr. 11/2018**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS FEDERALE TË
GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN
TEKNIK 2017, PËR PROJEKTIN
“ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM
EKONOMIK DHE RAJONAL, NXITJA E
PUNËSIMIT DHE ARSIMI
PROFESIONAL (SHTIM I DYTË
FONDESH)”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për



bashkëpunimin teknik 2017, për projektin “Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik dhe rajonal, nxitja e punësimit dhe arsimit profesional (shtim i dytë fondesh)”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 5.3.2018

Shpallur me dekretin nr. 10741, datë 12.3.2018, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM TEKNIK 2017

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe për t'i thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit teknik si partnerë;

të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje;

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;

duke iu referuar marrëveshjeve ndërkombëtare të iniciuara nga notat e Ambasadores së Republikës Federale të Gjermanisë, të datës 26 shtator 2016 dhe 23 janar 2017, të dyja në fuqi që nga data 29 maj 2017, të cilat kanë në përmbajtje mbështetjen e projektit “Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik dhe rajonal, nxitja e punësimit dhe arsimit profesional”, si dhe të shtimit të fondeve të tij, si dhe duke iu referuar premtimit financiar të Republikës Federale të Gjermanisë (nota verbale nr. 119/2017, datë 11 maj 2017), kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1

1. Në zbatim të Marrëveshjes shqiptaro-gjermane të datës 21 tetor 1988, “Mbi

bashkëpunimin teknik”, do të mbështetet projekti i mëposhtëm:

“Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik dhe rajonal, nxitja e punësimit dhe arsimit profesional (shtim i dytë fondesh)”, nëse nga shqyrtimi përkatës rezulton se ky projekt vlen për t'u mbështetur.

2. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë vë në dispozicion për shtimin e fondeve për projektin e përmendur në paragrafin 1 shërbime në personel dhe materiale, si dhe eventualisht kontribute financimi (grante), në një vlerë të përgjithshme prej gjithsej 6 000 000 eurosh (me fjalë: gjashtë milionë euro), nga të cilat janë parashikuar:

a) Deri në 2,5 milionë euro për masa gjatë vitit 2017;

b) Deri në 3,5 milionë euro për masa deri më 31 dhjetor 2019 (fundi i projektit).

Kësisoj, e tërë vlera e projektit “Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik dhe rajonal, nxitja e punësimit dhe arsimit profesional” arrin kështu, duke përfshirë shumat që janë vënë në dispozicion përmes notave të përmendura në preambul, të datave 26 shtator 2016 (5 500 000 euro) dhe 23 janar 2017 (shtim fondesh me 5 000 000 euro), në shumën 16 500 000 euro (me fjalë: gjashtëmbëdhjetë milionë e pesëqind mijë euro). Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë ngarkon me zbatimin e projektit Shoqërinë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (*Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit - GIZ GmbH*).

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë garanton një planifikim të vetin buxhetor, ku shpenzimet e ndryshme klasifikohen në zëra më vete, që të sigurojë kështu zbatimin e vazhdueshëm të projektit të përmendur në paragrafin 1 dhe kujdeset, që institucionet e ngarkuara prej tij me zbatimin e projektit të kryejnë shërbimet e nevojshme për projektin e përmendur në paragrafin 1.

4. Premtimi financiar për projektin e bashkëpunimit teknik të përmendur në paragrafin 1 do të zhvlerësohet pa kompensim, në rast se për premtimin financiar të përmendur në paragrafin 2, germa “a”, brenda datës 31 dhjetor 2017, nuk është lidhur ende kontrata përkatëse e zbatimit dhe eventualisht ajo e financimit, si dhe nuk janë livruar fondet ose respektivisht, për premtimin financiar të përmendur në paragrafin 2, germa “b”, deri në



fund të vitit 2021, nuk është lidhur ende kontrata përkatëse e zbatimit dhe eventualisht ajo e financimit.

Nëse kontratat e zbatimit dhe eventualisht ato të financimit lidhen brenda afateve të parashikuara vetëm për një pjesë të premtimit financiar, atëherë kjo klauzolë zhvlerësimi vlen vetëm për atë pjesë të fondeve, që nuk është ende objekt i këtyre kontratave.

Neni 2

Hollësitrat e projektit të përmendur në nenin 1, paragrafi 1, si dhe ato mbi shërbimet dhe detyrimet, që duhet të kryhen, do të përcaktohen në kontrata zbatimi dhe eventualisht edhe financimi të veçanta, që do të lidhen ndërmjet institucioneve, që janë ngarkuar apo do të ngarkohen me zbatimin e projektit në kuptimin e nenit 1, paragrafi 2 dhe 3. Kontratat e zbatimit dhe eventualisht të financimit u nënshtrohen dispozitave ligjore, që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

Neni 3

1. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i përjashton materialet, automjetet, mallrat dhe pajisjet, si dhe pjesët e këmbimit të livruara në kuadër të projektit të përmendur në nenin 1, paragrafi 1, me porosi dhe me shpenzimet e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, nga detyrimet tarifore për licencat, doganat, taksat e portit, të importit dhe të eksportit dhe nga taksa të tjera publike, sikurse edhe nga pagesat për magazinim dhe garanton, që materialet të zhdoganohen pa vonesë.

2. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton organizatën zbatuese të projektit nga të gjitha taksat dhe tatimet direkte, që lindin në Republikën e Shqipërisë nga lidhja dhe zbatimi i kontratave të zbatimit dhe eventualisht atyre të financimit të përmendura në nenin 2.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë rimbursion me kërkesën e organizatës zbatuese gjermane vlerën e TVSH-së apo të taksave të ngjashme indirekte, që janë mbajtur në Republikën e Shqipërisë mbi objektet e siguruara dhe shërbimet e kryera në kuadër të lidhjes dhe zbatimit të kontratave të zbatimit dhe eventualisht atyre të financimit të përmendura në nenin 2. Taksat mbi konsumin të mbajtura në

këtë kontekst merren përsipër prej Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë pas bërjes së kërkesës përkatëse.

Kjo marrëveshje vlen si për projektin e përmendur në nenin 1, paragrafi 1, ashtu edhe për masa të tjera vijuese nën të njëjtin titull, nëse qeveritë e dy vendeve tona do të duan të mbështesin më tej projektin. Premtimet financiare të Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për masat vijuese të projektit të përmendur në nenin 1, paragrafi 1, bëhen të ditura përmes njoftimesh zyrtare nga ana e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, e cila i referohet tekstualisht kësaj marrëveshjeje.

Neni 4

Edhe për këtë marrëveshje janë të vlefshme dispozitat e marrëveshjes së përmendur në nenin 1, paragrafi 1, të datës 21 tetor 1988, ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë “Mbi bashkëpunimin teknik”.

Neni 5

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

2. Kjo marrëveshje lidhet me një afat të pacaktuar. Secila palë kontraktuese mund ta shfuqizojë atë me shkrim në rrugë diplomatike në çdo kohë; shfuqizimi bëhet i efektshëm 30 ditë pasi pala tjetër kontraktuese ka marrë njoftimin përkatës.

3. Palët kontraktuese mund të bien dakord për ndryshime të kësaj marrëveshjeje.

4. Mosmarrëveshjet lidhur me interpretimin apo zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhen në mirëkuptim mes palëve përmes bisedash apo negociatash.

Bërë në Tiranë, më 19.12.2017, në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur të dyja tekstet fuqi të barabartë.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Për Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 364 lekë